

V E N D I M
Nr.665, datë 18. 12. 2002

PËR MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE “LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC.” PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAFIKUT AJROR SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994, “Për aviacionin civil shqiptar”, të nenit 17, pika 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik” dhe në vijim të vendimit nr.541, datë 31.10.2002, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e studimit të fizibilitetit të shërbimit ajror shqiptar,” përgatitur nga shoqëria ndërkombëtare “Lockheed Martin Global Inc.”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projektkontratës ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil), për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror, me vlerë 32.977.807 (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatë) USD.

2. Lejimin e Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror sha, që për fondin e vet prej 3.295. 000 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë) USD, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë” me shoqërinë ndërkombëtare “Lockheed Martin Global Inc.”, për zbatimin e fazës së parë të Projektit, sipas Projektkontratës së përmendur në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Vlefshmëria e Kontratës për zbatimin e fazës së dytë të Projektit është lidhur dhe do të zbatohet në përputhje me sigurimin e burimeve përkatëse të financimit dhe me hyrjen në fuqi të marrëveshjes për këtë qëllim.

4. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil dhe Ministria e Ekonomisë, nëpërmjet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror sha, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe nga Kontrata.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

KUSHTET DHE AFATET E KONTRATËS PËR PROJEKTIN E MODERNIZIMIT TË HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE (NAMP) TË SHQIPËRISË QEVERIA E SHQIPËRISË DHE LOCKHEED MARTIN GLOBAL INC. KONTRATA KRYESORE NË LIDHJE ME MODERNIZIMIN E HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE

Versioni 5
Numri i referencës: ALBGEN02-0025
22 nëntor 2002

KONTROLLI I DOKUMENTEVE TË KONTRATËS
HISTORIKU I NDRYSHIMEVE

Ripunimet	Data e botimit	Përmbledhje e ndryshimeve
Versioni 0.1	tetor 2002	Drafti fillestar
Versioni 1.0	4 nëntor 2002	Versioni bazë
Versioni 2.0	6 nëntor 2002	Versioni bazë
Versioni 2.1	7 nëntor 2002	Versioni fillestar i negociuar

Versioni 3	13 nëntor 2002	Versioni bazë i ripunuar
Versioni 4	13 nëntor 2002	Versioni bazë i ripunuar
Versioni 5	22 nëntor 2002	Versioni bazë i ripunuar

Kjo Marrëveshje, e bërë në datën _____, më poshtë referuar si “Kontratë”, lidhet ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të Qeverisë së Shqipërisë, me selinë e saj: Rruga e Kavajës, përballë Xhamisë, Tiranë, Shqipëri, më poshtë referuar si “Blerësi” dhe Lockheed Martin Global Inc., filial i Korporatës Lockheed Martin, me selinë e saj në adresën: 9211 Corporat Boulevard, Rockville, në shtetin Maryland të SHBA-së më poshtë referuar si “Shitësi”. Blerësit dhe Shitësit mundemi gjithashtu t'u referohemi në numrin njëjës si “Pala” ose në numrin shumës “Palët”.

DËSHMI:

Meqenëse, Shitësi dëshiron t'i sigurojë Blerësit mallra ose shërbime të caktuara ose të dyja këto; dhe

Meqenëse, Blerësi dëshiron të blejë mallrat ose shërbimet në fjalë ose të dyja këto së bashku me çmimin që jepet këtu dhe me kushtin që të bihet dakord për dispozitat dhe afatet; dhe

Meqenëse, Blerësi dhe Shitësi dëshirojnë të lidhin këtë Marrëveshje për gjithë programin për implementimin dhe modernizimin e plotë të infrastrukturës së ANS për periudhën nga 2002 deri 2006. Programi ndahet në dy faza:

Faza 1

Të ndihmohet Qeveria shqiptare për të siguruar financimin tregtar. Do të sigurohen mallrat dhe shërbimet e nevojshme për të mundësuar instalimin e sistemit fillestar të automatizuar, i cili do të bëjë të mundur që në Fazën e dytë të kalohet në sistemin e kontrollit me radarë. Do të sigurojë asistencë për funksionimin e trafikut ajror për të realizuar mundësinë e kontrollit me radar brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës, duke shfrytëzuar kushtet aktuale të kontrollit. Do të modifikohet dhe rregullohet ndërtesa ekzistuese e ACC/APP për të mundësuar instalimin e sistemit fillestar të automatizuar. Do të përfundojë grumbullimi i të dhënave për një kullë të re vërtetimi të ACC/APP. Do të realizohen detyrat e ndryshme në lidhje me funksionimin e Trafikut Ajror. Mendohet që kjo punë të financohet direkt nga fitimet e NATA-es në përputhje me ligjin shqiptar për taksat.

Faza 2

Do të sigurohet sistemi fillestar i automatizuar i cili do të mundësojë të kalohet në fazën e kontrollit me radarë që të jetë gati për trafikun e Lojërave Olimpikë në verën e vitit 2004 duke përfshirë hapjen e një sektori të ri në hapësirën aktuale. Do të projektohet dhe do të ndërtohet një kullë e re vërtetimi për ACC/APP. Do të modernizohen nënsistemet e automatizuara të komunikimit, të fluturimit, të survejimit dhe të drejtimit të Trafikut Ajror. Do të përfundojnë detyrat e ndryshme në lidhje me operimin e Trafikut Ajror. Do të livrohen mallrat e nevojshme me synimin për të funksionuar si një qendër virtuale për Qiellin e Vetëm Evropian (Single Sky). Do të ngrihet një zyrë për menaxhimin e Projektit me personel shqiptar, e cila do të marrë në dorëzim teknikën dhe do të aftësohet. Mendohet që fondi për këtë punë do të mbulohet nga financimi tregtar. Jemi të ndërgjegjshëm se realizimi i Fazës së dytë të Kontratës do të varet nga siguri në masën e mjaftueshme të financimit tregtar ose financime të tjera të pranueshme për të dyja Palët.

Propozimi ynë për të mos tejkaluar çmimin e Fazës së dytë bëhet me qëllim se me harxhimin e financimit tregtar dhe shpenzimet për sigurimin e rreziqeve mund të dalë e nevojshme të bëhen modifikime.

Prandaj, duke marrë në konsideratë premtimet dhe marrëveshjet e përbashkëta të shprehura më poshtë, Palët bien dakord si më poshtë:

1. Data e hyrjes në fuqi

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi kur të firmoset nga të dyja Palët, nga Blerësi dhe nga Shitësi, dhe t'u dorëzohet të dyja Palëve.

2. Objekti i Kontratës

Kjo Kontratë është për mallrat e shërbimet për Menaxhimin Ajror sipas përshkrimeve të shprehura

me poshtë.

3. Përkufizime

ARO (Pas marrjes së porosisë): Do të kuptohet periudha kohore duke filluar me datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate dhe dita menjëherë pas datës së hyrjes në fuqi do të jetë Dita 1 e ARO-s.

Përfaqësuesit e autorizuar: Do të kuptohen ata persona, me emër dhe tituj, që kanë të drejtën të zëvendësojnë secilën nga palët, dhe këtu përfshihen: përfaqësuesit e autorizuar rregullisht e në prezencë të tij direkt në kantier, siç specifikohet edhe në këtë Kontratë, ose persona të tjerë të bërë të ditur nëpërmjet njoftimeve që njëra Palë i dërgon Palës tjetër në përputhje me klauzolën për njoftimet, shprehur më poshtë.

Blerësi-Prona e furnizuar, personeli dhe mbështetja: Do të kuptohen avioni, pajisjet për mbështetjen tokësore, pjesë ndërrimi, dokumentacioni, personeli dhe mbështetja që do të livrohen nga Blerësi te Shitësi në përputhje me skemën e programit për Blerësi-Prona e furnizuar, personeli dhe mbështetja, në përputhje me raportin i punës.

Kalendar: Do të kuptohet kalendar i Gregorian, nëse nuk shprehet ndryshe.

Kërkesat për ndryshime: Do të kuptohet kërkesa për ndryshim e iniciuar nga Blerësi në përputhje me dispozitat e paragrafit 17, ose që ngrihet në bazë të rrethanave, të kushteve ose të ngjarjeve, përshkruar në këtë Kontratë.

Të dhënat: Do të kuptohen vizatimet, disenjot, shpikjet dhe informacionet e tjera teknike që do të furnizohen nga Shitësi dhe/ose Blerësi në bazë të kësaj Kontrate dhe raportit të punës (siç përcaktohet edhe më poshtë), duke përfshirë të gjitha pasqyrat dhe anekset bashkëlidhur.

Ditët: Do të kuptohen ditët kalendarike, nëse nuk shprehet ndryshe.

Artikuj të livrueshëm: Do të kuptohen artikujt e specifikuar në paragrafin 7, që Shitësi do t'ia livrojë Blerësit në përputhje me afatet e Kontratës.

Mospërputhje: Do të konsiderohet një defekt në material ose funksionimin e një artikulli, të një komponenti ose një pjese e cila nuk përputhet me specifikimet që aplikohen dhe rezulton ose mund të rezultojë me avari, ose një artikull, komponent ose pjesë që nuk hyn fare në punë.

Dollarë ose USD: Do të kuptohen dollarët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës që janë në qarkullim të lirë në SHBA.

Data e ekzekutimit: Do të kuptohet data kur firmoset kjo Kontratë nga Pala e fundit, siç shprehet edhe në faqen e fundit për nënshkrimin e kësaj Kontrate.

Data e hyrjes në fuqi: Do të kuptohet data në të cilën do të ndodhë ngjarja më e fundit e shënuar në klauzolën e Kontratës për hyrjen e saj në fuqi.

Përdoruesi: Do të kuptohet personi juridik i autorizuar nga Blerësi për të importuar mallrat e livrueshme sipas Kontratës dhe përgjigjet për trajtimin e çështjeve teknike sipas kësaj Kontrate. Për qëllimin e kësaj Kontrate termi “Blerësi” dhe “Përdoruesi” do të përdoren të alternuar.

Pajisjet: Do të kuptohet hardware (dhe manualët teknike përkatëse) që i jepen Blerësit sipas kushteve të kësaj Kontrate.

Qeveria e Shqipërisë: Do të kuptohet çdo dikaster ose autoritet i Qeverisë së Shqipërisë, veprimet e të cilëve mund të influencojnë në këtë Kontratë.

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës: Do të kuptohet çdo agjenci ose autoritet i Qeverisë së SHBA-së, veprimet e të cilëve mund të prekin këtë Kontratë.

Dhuruesi: Do të kuptohet pronari i licencës të software dhe autori që gëzon të drejtën mbi produktet e programit që do t'i jepen përfituesit në formë granti, në përputhje me klauzolën 26, shprehur më poshtë.

Përmirësime: Do të kuptohet çdo pjesë ose kombinim pjesësh, ose metodë përdorimi, mirëmbajtjeje, përshtatjeje, azhurnimi, prodhimi dhe/ose përpunimi ose nga ato të shprehura më sipër, përdorimi i të cilave influencën në të drejtat mbi të dhënat që janë në pronësi dhe licencë të Shitësit në një ose më shumë rrugë të mëposhtme: (1) ul shpenzimet në prodhim; (2) përmirëson funksionimin; (3) zgjat jetën e shërbimit; (4) zgjeron fushën e aplikimit; (5) rrit aftësinë e marketingut; dhe/ose (6) përmirëson pamjen e jashtme.

Faturë: Do të kuptohet një listë me zëra shërbimesh të ndryshme dhe/ose mallra nisur për te Blerësi.

Muaj: Do të kuptohen muajt kalendarikë, nëse nuk shprehen ndryshe.

Njoftim: Do të kuptohet, ndërmjet Palëve, një njoftim me shkrim i dërguar nga njëra palë te Pala tjetër në përputhje me klauzolën për njoftimet shprehur më poshtë.

Produkte: Do të kuptohen pajisje, programe, dokumentacioni teknik, shërbimi teknik, trajnimi teknik dhe pjesët e këmbimit të livruara sipas kësaj Kontrate.

Produktet e programit: Do të kuptohet software që është pronë e Shitësit ose e një Pale të tretë dhe i livrohet Blerësit sipas kushteve të kësaj Kontrate. Software pronë e Shitësit përfshin Software komercial të disponueshëm (CAS) dhe software i përshtatur dhe i përpunuar vetëm për këtë kontratë.

Skema e programit: Do të kuptojë skemën e programit bashkëlidhur kësaj, si aneksi 4 dhe që është pjesë përbërëse e kësaj Kontrate.

Marrësi: Do të kuptohet Blerësi ose Përdoruesi i fundit, i cili do të marrë licencën e software dhe të drejtën e autorit për produktet e programit dhënë në formë granti nga Shitësi në përputhje me klauzolën 26 më poshtë.

Raporti i Punës: Do të kuptohet raporti i punës bashkëlidhur këtu si aneksi 2 dhe që është pjesë përbërëse, i cili përmban punimet që do të kryhen, materialet, shërbimet, procedurat e aplikueshme dhe një grafik livrimi për mallrat dhe/ose shërbimet që do të sigurohen sipas kësaj Kontrate nga Shitësi për Blerësin në përputhje me këtë Kontratë.

Dokumentacioni teknik: Do të kuptohen të gjitha dokumentet e projektit që do të livrohen sipas kësaj Kontrate, siç specifikohet edhe në paragrafin 7.

Shërbimi teknik: Do të kuptohen instruksionet teknike, asistenca dhe supervizioni që do të kryhen nga Shitësi për Blerësin.

Trajnimi teknik: Do të kuptohet trajnimi teknik që do të kryhet nga Shitësi për Blerësin dhe/ose Përdoruesin e fundit në lidhje me instalimin, me funksionimin dhe me mirëmbajtjen e pajisjeve dhe me punët e tjera për objektin e Kontratës siç përcaktohen këtu.

Ditë pune: Do të kuptohet ditët normale të punës të caktuara për çdo vend, ku kryhen punimet përkatëse, rregullisht duke përfshirë festat dhe fundjavën.

4. Radha e përparësive

Në rast të ndonjë mospërputhjeje ose mëdyshjeje në lidhje me dokumentet që përbëjnë komponentë të kësaj Kontratë, mospërputhja ose mëdyshja në fjalë do të zgjidhet duke përdorur radhën e mëposhtme në përparësinë e dokumenteve:

1. Kushtet dhe afatet e Kontratës.
2. Aneksat numër 1, 2, 3 dhe 4 për kushtet dhe afatet e Kontratës, sipas numrit rendor.
3. Çdo dokumentacion tjetër.
4. Marrëveshja financiare për Fazën 2.
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave për studimin e fizibilitetit.
5. Vendi i realizimit

Kjo Kontratë mund të realizohet në mjediset e Shitësit në të gjithë botën dhe në mjediset e Blerësit në të gjithë Shqipërinë, siç mund të specifikohet në shtojcën e Projektit.

Grafiku i realizimit dhe afati i Kontratës

Periudha e realizimit të kësaj Kontrate (e thënë gjithashtu “Afati i Kontratës”) fillon nga data e hyrjes në fuqi deri në 20 dhjetor, dhe mund të zgjatet me marrëveshjen e të dyja Palëve. Një grafik i hollësishëm për realizimin, duke përfshirë edhe afatet e ndërmjetme të realizimit, afatet e livrimit, afatet e marrjes në dorëzim, afatet e garancisë janë përfshirë në Grafikon e programit në aneksin 4 bashkëlidhur.

7. Zërat që livrohen dhe çmimet

Zërat që do të livrohen, do të specifikohen në raportin e punës në Aneksin 2. Vlefë e fillestare e kësaj Kontrate është 3.295.000 USD për Fazën 1. Vlefë që mendohet për Fazën 2 është 29.682.807 USD pas konfirmimit të financimit për Fazën 2. Kjo do të rezultojë në një vlefë totale prej 32.977.807 USD.

Në çdo kohë para ngarkimit të mallrave që do të livrohen, Shitësi rezervon të drejtën të bëjë

korrigjimet e nevojshme ose ndryshime në lidhje me numrin, komponentët dhe faturën e materialeve, me kusht që forma, montimi dhe lidhja e pjesëve dhe e komponentëve nuk do të cenohen. Të gjithë zërat do të livrohen në kushtin CIF, vendi i Blerësit.

Grafiku i pagesave

Pas firmosjes së Kontratës, Blerësi do të bëjë pagesën në bankën e Shitësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të Kontratës me marrjen e 1 një kopjeje të kontratës të firmosur dhe 3 (tre) kopjeve të faturave tregtare origjinale të Shitësit.

Pagesat e tjera janë në opsion të Shitësit, në afatet dhe datat e specifikuara në planin e pagesave me faza që janë në aneksin 3 dhe me kusht që të lëshohet një garanci bankare, e cila shpjegohet me hollësi në aneksin 5.

Blerësi nuk do të bëjë pagesë për punë që nuk përputhen me kriteret e pranuar në këtë Kontratë.

Plani i pagesave për Fazën 2 do të vendoset gjatë Fazës së parë në përputhje me Marrëveshjen e financimit.

Për Fazën 2, në marrëveshje ndërmjet dy Palëve, do të bihet dakord edhe për një klauzolë për eliminimin e defekteve.

Faturat për pagesat do të lëshohen nga Shitësi 30 ditë 30 kalendarike para datave të caktuara.

Implementimi i Kontratës së Fazës së dytë hyn në fuqi kur të jetë çelur kredia dhe të dyja Palët të bien dakord për një amendament të Kontratës.

Mënyra e pagesës/Monedha

Pagesat do të bëhen me transferim elektronik të shumave në llogarinë e Shitësit në:

Citibank

399 Park Avenue

New York 10022, USA

ABA:0210-008-9

Nr. i llogarisë: 4070-3579

Të gjitha pagesat do të bëhen në USD dhe do të jenë neto e nuk ngarkohen me ndonjë tarifë bankare ose konvertim monedhe. Pagesat avancë do të jenë objekt i Garancisë për pagesat avancë që do të vendosen ndërmjet Palëve.

Letërkredia dokumentare

Faza 1

Brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Blerësi dhe Shitësi, Blerësi do të çelë në favor të Shitësit një Letërkredi dokumentare të pakthyeshme në një bankë siç shprehet në aneksin 7 bashkëlidhur Kontratës. Letërkredia do të çelet me afat 12 (dymbëdhjetë) mujor dhe do të jetë në shumën ekuivalent me vlefën totale të Fazës së parë të Kontratës, zbrit pagesën për nënshkrimin e Kontratës (pagesa avancë e specifikuar në aneksin 3). Nëse financimi tregtar për Fazën 2 nuk merret nga Blerësi deri në 30 (tridhjetë) ditë para se të skadojë afati i Letërkredisë, Blerësi do ta shtyjë afatin e Letërkredisë aq sa ajo të qëndrojë e hapur dhe e disponueshme për t'u tërhequr deri dyzet ditë (40) pasi borxhdhënësi do të hapë linjën e kredisë për financimin tregtar. L/C do të konfirmohet nga një bankë në SHBA e pranueshme nga Shitësi dhe do të jetë e lirë për t'u negociuar dhe për t'u paguar me paraqitjen në SHBA. Detyrimet bankare që ngarkohen në Shqipëri, plus dhe shpenzimet për konfirmimin, do të mbulohen nga Blerësi. Detyrimet bankare që rezultojnë jashtë Shqipërisë, duke përjashtuar tarifat e konfirmimit, do të përballohen nga Shitësi. Pagesat avancë do të jenë objekt i një Shtojce të Letërkredisë e rënë dakord nga të dyja Palët, në shumën siç pasqyrohen në aneksin 6 bashkëlidhur.

Letërkredia e Fazës së dytë do të vendoset gjatë Fazës së parë në përputhje me Marrëveshjen e financimit.

Kufizimi i fondeve

Palët e pranojnë se Blerësi mund të mos vërë në dispozicion të gjithë financimin të barabartë me çmimin e Kontratës. Shuma e fondit të autorizuar është 3.295.000 USD. Palët pranojnë se fondi i dhënë është i mjaftueshëm për financimin e Fazës së parë të Kontratës. Palët pranojnë se fonde shtesë do të sigurohen nëpërmjet financimit tregtar dhe burimeve të tjera të rena dakord nga të dyja Palët për të

financuar Fazën 2 të Kontratës dhe të bëjë të mundur dhënien e financimit për gjithë shumën totale të çmimit të Kontratës. Palët pranojnë dhe bien dakord se realizimi i Fazës së dytë të Kontratës do të varet sa Palët do të sigurojnë financimin tregtar ose financime të tjera, të pranuar bashkërisht.

Shitësi pranon të kryejë ose të ketë kryer punë për Kontratën deri në pikën që shuma totale e marrë nga Blerësi është e përafërt, por nuk e kalon nivelin e financimit të autorizuar, duke i kushtuar vëmendjen e duhur ndonjë anulimi të mundshëm të detyrimeve që mund të ndërmarrë Blerësi. Kjo shumë e caktuar do të përfshijë të gjitha shpenzimet, raste të veçanta, tarifën, përfitimet dhe shpenzimet operative të kryera dhe çdo detyrim të pritshëm që Shitësi do të duhet të përballojë.

Taksat dhe tarifën doganore

Për Fazën 1, çdo taksë, detyrim dhe tarifa të tjera që vihen nga qeveria e Blerësit dhe/ose nga ndonjë nëngrupim politik i mundshëm që është në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate, do të përballohen nga Blerësi. Nëse është rënë dakord që taksat të paguheshin nga Shitësi, kjo do të jetë objekt i një modifikimi që mund t'i bëhet Kontratës në marrëveshje të përbashkët dhe të vendoset para se të fillojë kryerja e pagesave. Taksat, detyrimet dhe tarifën e vëna nga ndonjë qeveri tjetër ose nëngrupim politik që do të përbënte një detyrim e shpenzim tjetër për Shitësin ose për furnizuesit e tij ose për personelin e Shitësit ose furnizuesit e tij, ose në dëm të pasurisë së ndonjërit përmendur më sipër, gjatë realizimit ose anulimit ose përfundimit të kësaj Kontrate, do t'i shtohen vlefës totale të kësaj Kontrate. Këto shtesa do të paguheshin menjëherë nga Blerësi sipas kërkesës me shkrim nga Shitësi.

Nëse Blerësit do t'i kërkohej me ligj të bëjë ndonjë zbritje ose të mbajë ndonjë shumë për të paguar ndonjë taksë, tarifë ose detyrim tjetër çfarëdo për pagesat që do të duhet të bëjë për këtë Kontratë, shuma që duhet paguar do të shtohet dhe, pasi të jenë bërë të gjitha zbritjet e kërkuara, Shitësi do të marrë të njëjtën shumë të barabartë me atë vlefë që ai duhet të merrte në datën e caktuar të pagesës sikur të mos ishte bërë asnjë zbritje ose mbajtur ndonjë vlefë.

Për Fazën 2, mënyrat për pagesën e taksave do të përcaktohen në përputhje me marrëveshjen e financimit dhe me amendamentet e tjera të Kontratës.

Kontrolli dhe miratimi

Kontrolli dhe miratimi i të gjithë zërave që do të livrohen, do të përcaktohen dhe do të dokumentohen në Planin e testimit. Ky Plan testimi do të përgatitet nga Shitësi dhe do të miratohet nga Blerësi dhe me t'u miratuar në këtë mënyrë, do të jetë i detyrueshëm për të dyja Palët. Plani i testimit do të përshkruajë të gjithë procesin, çdo testim të veçantë dhe do të përmbajë ndarje të veçanta për të trajtuar testimet e pranimit dhe të miratimit. Plani i testimit do të hartohet dhe do të përcaktojë kriteret kaluese/mbetëse për çdo testim dhe kriteret e përgjithshme për kalim/mbetje për të dyja testimet. Testet mund të kryhen me anën e demonstrimeve ose nëpërmjet analizave.

Sipas dëshirës së tij, Blerësi mund të marrë pjesë në të gjitha testimet ose në ndonjë testim të veçantë. Të gjitha shpenzimet që lidhen me aktivitetet e Blerësit përballohen nga Blerësi. Pas përfundimit të testeve, Shitësi do t'i paraqesë Blerësit Raportet për testimet e kryera, siç përcaktohet në Planin e testeve. Raportet e testeve janë dokumente statutorë dhe nuk janë mallra që livrohen e duhen pranuar ashtu siç janë. Përfundimi me sukses i testeve do të dokumentohet duke përgatitur të dyja Palët një protokoll për marrjen e miratimit, ku do të shënohet çdo mungesë që do të pranohet nga të dyja Palët, të cilat do të korrigjohen më vonë, dhe zyrtarisht e bashkërisht do të lëshohet Certifikatë Miratimi. Këto dokumente do të përgatiten brenda 14 ditëve pas mbarimit të testeve. Për qëllime të garancisë, data e këtyre dokumenteve do të konsiderohet si datë e marrjes në dorëzim, siç përshkruhet edhe në nenin 21.

Shpenzimet për përsëritjen e testeve të pranimit, për arsye të gabimeve të Shitësit, do të përballohen nga Shitësi. Brenda 60 ditëve nga data e fundit për pranimin e testeve për Fazën 2, Blerësi duhet të bëjë gati mjediset për punë.

Shfrytëzimi i mjedisve

Blerësi duhet të sigurojë që Shitësi të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme që do të mundësojnë atë të hyjë në kantier dhe të shfrytëzojë pajisjet e furnizuara nga klientët, me qëllim që të kryejë plotësisht të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Kontrata.

Miratimi i dokumenteve

Dokumentet e nevojshme që kërkojnë konfirmimin dhe miratimin e Blerësit do t'i paraqiten përfaqësuesit të caktuar të Blerësit për t'i shqyrtuar dhe bërë vërejtje. Blerësit i lihen 21 ditë kalendarike nga data e livrimit të dokumenteve për t'i dërguar Shitësit vërejtjet e tij me shkrim. Nëse Blerësi nuk do të dërgojë vërejtjet e tij brenda afatit kohor të caktuar, kjo do të konsiderohet si miratim i dokumenteve nga ana e Blerësit. Brenda 21 ditëve nga marrja e vërejtjeve të Blerësit, Shitësi do të bjerë dakord me korrigjimet e Blerësit për t'u përfshirë në dokumentin final. Pranimi i dokumentit përfundimtar kryhet me livrimin e tij.

Paketimi dhe transporti

Për të gjitha livrimet, Shitësi do të përdorë paketimin tregtar, duke patur parasysh kushtet klimaterike dhe të magazinimit në destinacion. Blerësi përgjigjet për të gjitha formalitetet doganore. Shitësi do t'i dërgojë Blerësit dokumentet për formalitetet doganore 7 ditë kalendarike para mbërritjes së mallit.

Ndryshimet

Nëse është dakord Shitësi, Blerësi mund të kërkojë ndryshimin e objektit të punës, grafikun e çmimeve dhe dispozitat e tjera të Kontratës në marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve, para se të bëhen ndryshimet.

Shpenzimet e Shitësit për: (a) vonesat e shkaktuara nga Blerësi, si dhe nga vonesa të tjera (me përjashtim të vonesave që janë brenda normave të kontrollit të nevojshëm të Shitësit), (b) ndryshimet në zbatimin e ligjeve dhe kërkesave pas datës së Ofertës të Shitësit; dhe (c) testimet ose kontrollet e tjera që mund të kërkojnë nga Blerësi, përveç atyre që kërkojnë në përputhje me programin për garantimin e cilësisë nga Shitësi, do të trajtohen si ndryshime të objektit të punës dhe Kontrata do të rregullohet siç shprehet në paragrafin e mësipërm.

Gjuha

Të gjitha komunikimet, njoftimet, zërat për livrim, manualët dhe korrespondenca në lidhje me këtë Kontratë dhe me Projektin, që do të shkëmbehen ndërmjet Blerësit dhe Shitësit, do të jenë vetëm në gjuhën angleze.

Njoftimet

Çdo njoftim i kërkuar ose që është i nevojshëm në bazë të kushteve të Kontratës, do të bëhet me shkrim dhe do të dërgohet ose në dorë, faksimile, postë rekomande në adresat e mëposhtme:

Për Blerësin:
Merita Xhafaj
Drejtoresh e Përgjithshme e Aviacionit Civil
të Shqipërisë

Kopje për:
Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror
Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza"
Rinas, Shqipëri.

Kutia postare 205
Rruga e Kavajës
Përballë Xhamisë
Tirana, Shqipëri
Tel. +355 422
e-mail dpac2@albn.net

Për Shitësin:
NL. Shreeve
C/o Lockheed Martin Air Traffic Management
Building 7000, Langstone road
Havant, Hants, PO9 1SA
England
Tel. +44 1489 612562
e-mail nigel.shreeve@lmco.com

Gjithashtu mund të përdoren adresa të tjera që secila Palë sipas rastit do të njoftojë me shkrim Palën tjetër. Palët do të shqyrtojnë çdo njoftim të dërguar nëse është dorëzuar në datën e livruar nëse dërgohet me telex ose postë në ditën e transmetimit dhe do të konfirmojnë marrjen. E-mail-i është gjithashtu i përshtatshëm për komunikim zyrtar.

Pronësia dhe rreziku i humbjes

Pronësia për të gjithë zërat e livruar do t'i kalojë Blerësit me konfirmimin e bankës së Lockheed Martin ose nga institucione të tjera financiare që Shitësi ka marrë pagesën. Blerësi e ka të qartë se pronësia për pasurinë intelektuale të livrueshme (software, manuale etj.) është e vlefshme vetëm për mediat fizike

dhe se këto livrime licencohen sipas dispozitave të nenit 26.

Risku i humbjes për të gjithë elementet e livrueshme transferohet nga Shitësi te Blerësi me marrjen në dorëzim në bankinën e ngarkimit të Blerësit.

21. Garancia dhe ndihma për mirëmbajtjen

1. Shitësi do të japë mbështetje për Garancinë, siç përcaktohet në nenin 21, për një periudhë prej 24 muaj, duke filluar me nënshkrimin e Certifikatave përkatëse të pranimi në destinacion (në vendin e punës).

2. Brenda një afati kohor të arsyeshëm, pas njoftimit nga Blerësi, Shitësi zëvendëson ose riparon me shpenzimet dhe opsionin e tij çdo artikull të livruar, i cili, gjatë periudhës së garancisë nxjerr defekte gjatë përdorimit, qoftë si material, ashtu edhe si diseno ose, nga ana tjetër, nuk përputhet me kërkesat e Kontratës dhe ka një impakt të kundërt në funksionimin e sistemit.

3. Në rast se plotësimi i ndonjë detyrimi të Shitësit sipas nenit 21 rezulton me ndryshime kundrejt dokumentacionit të livruar, Shitësi me shpenzimet e veta do të zëvendësojë ose do të korrigjojë këtë dokumentacion siç është livruar fillimisht.

4. Nëse Blerësi nuk i jep Shitësit aksesin e plotë në sistem sipas kërkesës së tij, atëherë periudha e garancisë anulohet menjëherë.

5. Gjatë afatit të garancisë, Shitësi do të përgjigjet për të gjitha shpenzimet e tij që lidhen me çdo veprim që do të kryejë për të plotësuar detyrimet e tij që lindin këtu.

6. Në asnjë rast Shitësi nuk është përgjegjës për pajisjet ose software-t të cilat ndryshohen, modifikohen ose riparohen nga palë të tjera përveç Shitësit; për defekte ose dëmtime që rezultojnë nga manipulimi, magazinimi, funksionimi, mirëmbajtja, lidhje ose instalim i bërë keq nga palë të tjera përveç Shitësit; ose për defekte që rrjedhin nga amortizimi normal ose shfrytëzimi i tepruar.

7. Shitësi do t'i dërgojë Blerësit me shkrim planin e veprimeve për mirëmbajtjen, ku përcaktohen procedurat që do të ndjekë Blerësi për të realizuar mirëmbajtjen. Periudha e garancisë do të anulohet menjëherë nëse Blerësi nuk zbaton planin e veprimeve për mirëmbajtjen.

8. Garancitë në këtë nen janë ekskluzive dhe në vend të të gjitha garancive të tjera, qofshin statutores, të shprehura ose të zbatuara (duke përfshirë të gjitha garancitë e aftësisë tregtuese të mallrave dhe të përshtatjes për qëllime të caktuara, dhe të gjitha garancitë që rrjedhin nga ecuria e biznesit dhe marrjes me tregti). Mjetet ligjore që jepen këtu janë mjete ekskluzive të Blerësit për çdo dështim të Shitësit në plotësimin e detyrimeve të tij. Korrigjimi i çdo defekti ose mospërputhjeje në formë ose afatet e dhëna më sipër, konsiderohen se Shitësi i ka plotësuar komplet detyrimet e tij, nëse ankesat e Blerësit bazohen në kontratë, në gabimet (duke përfshirë neglizhencën ose detyrimet strikte) ose të shfaqura ndryshe gjatë punës së bërë këtu për realizimin e Kontratës.

22. Mirëmbajtja e sistemit

Shitësi pranon të kryejë shërbime për mirëmbajtjen afatgjatë të sistemit, që do t'i sigurohen Blerësit në bazë të një kontrate të veçantë për mirëmbajtjen, e cila do të hyjë në fuqi me përfundimin e afatit të garancisë që i jepet këtu sistemit. Kjo Kontratë mirëmbajtjeje do të jetë objekt negociatash, kushtesh e afatesh të pranuar nga të dyja Palët, duke përfshirë çmimet dhe pagesat dhe do të hyjë në fuqi kur të nënshkruhet nga të dyja Palët. Objekti dhe gjerësia e shërbimeve që do të ofrohen, minimalisht, do të jenë në përputhje të plotë me nivelin e shërbimeve që do të jepen në kuadrin e garancisë së kësaj Kontrate.

Detyrimet

Sa herë që Blerësit i kërkohet, në bazë të kushteve të kësaj Kontrate ose kërkesave të ligjit, të japë miratimin e tij, aprovimin, lejen dhe pranimin e tij për ndonjë çështje, ai nuk duhet t'i vonojë ato pa pasur arsye, por t'i japë në kohën e duhur, me qëllim që të evitojë çdo vonesë që mund t'i shkaktohet Shitësit në kryerjen e detyrimeve të tij ose Projektit në përgjithësi. Nëse Blerësi nuk e shpreh mosaprovimin e tij me shkrim, atëherë ky miratim, aprovim, leje ose pranim do të konsiderohet se është dhënë pas kalimit të një periudhe prej 21 (njëzet e një) ditë kalendarike nga kërkesa e bërë për këto nga ana e Shitësit.

Heqja dorë nga një e drejtë

Asnjë vonesë ose shtyrje afati nga ndonjë Palë në ekzekutimin e ndonjë të drejte, kompetence ose

mjeti ligjor sipas kësaj Kontrate nuk do të quhet ose të konsiderohet dorëheqje nga kjo e drejtë, kompetencë ose mjet ligjor. Çdo heqje dorë nga një Palë prej obligimeve të një pale tjetër sipas kësaj Kontrate do të bëhet me shkrim dhe nënshkruar nga pala që jep dorëheqjen nga një e drejtë. Çdo ushtrim i vetëm ose pjesor i ndonjë të drejte të tillë, kompetence ose mjeti ligjor nuk do të pengojë asnjë Palë tjetër në ushtrimin e veprimeve të tjera të një të drejte të tillë, kompetence ose mjeti ligjor tjetër.

Lejet dhe licencat

Të gjitha pajisjet dhe mjetet që duhet të kenë licencë ose leje nga organet shtetërore për shfrytëzimin e tyre nga Blerësi, këto licenca e leje duhen të merren para se të fillojë puna e lejuar. Është përgjegjësia e Blerësit t'i marrë këto licenca e leje në kohën e duhur. Nëse mungesa e këtyre lejeve ka një impakt të kundërt në realizimin e Projektit, atëherë do të konsiderohet si ndryshim i radhës, siç jepet edhe në nenin 17.

Ruajtja e informacioneve

Palët pranojnë se mund të dalë e nevojshme të shkëmbejnë informacione konfidenciale ose pronë e dikujt gjatë realizimit të kësaj Kontrate. Palët bien dakord se të gjitha këto shkëmbime do të kryhen në përputhje me një Marrëveshje të Veçantë që do të negociohet dhe do të pranohet bashkërisht në lidhje me Shkëmbimin e Informacioneve në Pronësi.

Licenca software/E drejta e autorit

a. Pronësia

Blerësi e pranon Shitësin si pronar ose licencues të produkteve të programit. Blerësi e ka të qartë se Produktet e Programit janë e drejta e Shitësit ose e ndonjë licencuesi tjetër dhe i nënshtrohen Konventës së Bernës. Blerësi nuk fiton asnjë të drejtë mbi Produktet e Programit me përjashtim të rasteve të veçanta që jepen falas sipas licencës. Blerësi mund t'i shfrytëzojë Produktet e Programit vetëm në Qendrën e Kontrollit të Trafikut Ajror në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” (ose në mjediset e tjera të caktuara e të pranuar nga të dyja Palët, më poshtë referuar si “Mjediset e caktuara”) për qëllime të kontrollit të trafikut ajror në hapësirën ajrore që kontrollohet në Shqipëri.

b. Përdorim i autorizuar

Me anën e kësaj Shitësi i jep Blerësit një licencë jo ekskluzive, të patransferueshme, vetëm për përdorim të brendshëm, e paguar plotësisht, për të përdorur Produktet e Programit vetëm në mjediset e caktuara. Kjo licencë është për të përdorur Produktet e Programit dhe nuk është ndonjë Marrëveshje shitblerjeje. Pjesët e produkteve të programeve që lexohen mekanikisht jepen vetëm me kod.

Blerësi autorizohet nga Shitësi:

1. Të përdorë pjesët e lexueshme mekanikisht të Produkteve të Programit në mjediset e caktuara.
2. Të magazinonjë Produktet e Programit, t'i transmetojë dhe t'i shfaqë në makinën e vendosur në mjediset e caktuara.
3. Të përdorë pjesët që nuk lexohen mekanikisht të Produkteve të Programit në mbështetje të autorizimit dhënë Blerësit për përdorimin e Produkteve të Programit.
4. Në bazë të autorizimit të marrë, të kopjojë ose të përkthejë pjesët e lexueshme mekanikisht të Produkteve të Programit në një format tjetër për të ndihmuar Blerësin në shfrytëzimin e Produkteve të Programit për të cilët është autorizuar.

5. Blerësi mund të bëjë, pa ndonjë miratim tjetër nga Shitësi, deri në tri kopje për Produktet e Programit vetëm për qëllime arshivimi ose për të evituar dëmtimin. Të gjitha kopjet e bëra do të riprodhojnë të gjitha shënimet në pronësi, të rezervuara ose me autorësi dhe Shitësit do t'i jepen llogaria në rast se kërkohen të gjitha kopjet. Të gjitha kopjet e bëra janë objekt i kushteve të kësaj licence.

Blerësit i jepet e drejta të shpërndajë rezultatet e Produkteve të Programit vetëm brenda dhe ndërmjet mjedisëve të caktuara.

Blerësi nuk mund të japë akses për Produktet e programit, duke përfshirë edhe një akses të kufizuar, asnjë pale tjetër, ose konsulentëve e kontraktuesve që mbështesin Programin, pa marrë më parë miratimin me shkrim të Shitësit. Ky miratim mund të jepet vetëm pasi të gjithë personat e angazhuar do të kenë nënshkruar një marrëveshje konfidencialiteti të pranueshme nga Shitësi. As Blerësi dhe as ndonjë palë tjetër e tretë nuk do të kopjojë Produktet e Programit të furnizuar nga Shitësi në çdo formë të

mundshme, me përjashtim të rasteve të veçanta, të autorizuar nga kjo licencë.

c. Kufizimet në përdorim

1. Blerësi nuk mund të ndryshojë montimin, të ndryshojë inxhinierin, të ndryshojë përbërjen dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të përpiket të deshifrojë plotësisht ose pjesërisht logjikën ose koherencën e Produkteve të Programit.

2. Blerësi nuk është i autorizuar të japë licencë për Produktet e Programit ose këtë licencë t'ia japë një Pale të tretë.

3. Blerësi mund të mos i kopjojë pjesët e lexueshme mekanikisht të Produkteve të Programit.

4. Blerësi mund të mos i kopjojë pjesët e lexueshme jo mekanikisht të Produkteve të Programit, nëse nuk është autorizuar në mënyrë të veçantë në këtë Kontratë.

5. Në rast të një konflikti ndërmjet kushteve të kësaj licence dhe kushteve të licencës së marrë nga Shitësi për produktet e Programit dhe është në pronësi të palëve të treta dhe nën-licencuar te Blerësi, licenca e palës së tretë do të konsiderohet si dokumenti mbizotërues.

6. Blerësi mund të mos i modifikojë Produktet e Programit ose të krijojë ndryshe derivate nga Produktet e Programit.

d. Afati i licencës

Licenca e dhënë me këtë rast do të jetë në fuqi dhe e vlefshme nëse Shitësi nuk e anulon këtë Kontratë, për arsye të shkeljeve që mund t'u bëjë Blerësi kushteve të saj. Menjëherë pas anulimit, Blerësi do t'i kthejë Shitësit të gjitha orgjinalet dhe kopjet e produkteve të Programit, të lexueshëm nga njeriu ose mekanikisht, plotësisht ose pjesërisht, të gjitha programet e dhëna sipas Kontratës dhe të shuajë e të prishë të gjitha formatet e Produkteve të Programit që mund të jenë vendosur diku.

e. Shumëzimi i Produkteve të Programit

Çdo Produkt i Programit që Shitësi i ka dhënë Blerësit, i cili rregullon, plotëson dhe ndihmon Produktet e Programit të furnizuar me këtë rast, do të konsiderohen si pjesë e Produkteve të Programit të marra këtu dhe do t'i nënshtrohen të gjitha kushteve të kësaj licence.

f. Blerësi pranon që të mbajë në konfidencë Produktet e Programit. Në mënyrë të veçantë, Blerësi miraton të mos shpërndajë tek asnjë palë e tretë Produktet e Programit dhe të ndërmarrë hapa të tillë që normalisht Blerësi duhet të ndërmarrë për të parandaluar shpërndarjen te palë të treta materialet e tij konfidenciale. Blerësi gjithashtu pranon që të mbajë në konfidencë Produktet e Programeve të tilla sipas nevojave dhe në përputhje me rregullat e Konventës së Bernës.

28. Shkeljet ligjore

1. Me shpenzimet e tij Shitësi do të mbrojë ose, në opsion të tij, do të vendosë për çdo padi ose proces gjyqësor të ngritur kundër Blerësit që mund të bazohet në ndonjë denoncim se ka përdorur për qëllimet e tij ndonjë shërbim, Produkte të Programit (qoftë edhe pjesë të tyre) dhe që përbëjnë shkelje të drejtave të autorit në SHBA në kohën që bëhet shitja në vendin e Blerësit, nëse:

a) në rastin e shkeljes së një patente, ekziston një patentë në SHBA që korrespondon me një patentë të tillë në vendin e Blerësit dhe që është në fuqi në këtë kohë;

b) denoncimi në fjalë për shkelje ligjore do të aplikohet edhe për patenta ose të drejtë autori të tilla në SHBA që bëhen shkak për të ngritur padi për shkelje sipas ligjeve të SHBA sikur shkelja e denoncuar të kishte ndodhur në SHBA.

c) Shitësi duhet të informohet menjëherë me shkrim nga Blerësi dhe t'i jepen kompetenca, informacione në kohën e duhur në mbrojtje të padisë në fjalë ose të ndonjë procesi gjyqësor.

Shitësi do të paguajë të gjitha shpenzimet dhe dëmtimet e llogaritura nga padia ose procesi gjyqësor të mbrojtur kështu.

Shitësi nuk përgjigjet për zgjidhje të ndonjë padie ose procesi gjyqësor të bërë, pa u vënë më parë në dijeni me shkrim. Në rast se ndonjë shërbim, Produkt Programi, ose pjesë të tyre, si rezultat i një procesi të mbrojtur në këtë mënyrë, vendoset të quhet shkelje ligjore ose përdorimi i tyre është urdhëruar nga Blerësi, Shitësi, me opsionin dhe shpenzimet e tij do të: (a) prokurojë për Blerësin të drejtën për të vazhduar të përdorë shërbimin në fjalë ose produktin e Programit; (b) zëvendësojë atë me një Produkt Programi ekuivalent dhe që nuk përbën shkelje; (c) modifikojë atë me qëllim që të mos quhet shkelje

ligjore; ose (d) nëse të gjitha bien poshtë, të rifinancojë një pjesë të çmimit paguar Shitësit.

2. Shitësi nuk do të ketë ndonjë detyrim ose obligim për Blerësin sipas këtij neni, përderisa shërbimi ose Produkti i Programit është: (a) livruar sipas disenjës së Blerësit ose instruksioneve e tij të cilat e kanë bërë Shitësin të devijojë nga kursi normal i zbatimit; (b) modifikuar nga Blerësi ose kontraktuesi i tij pas livrimit; ose (c) përzier nga Blerësi ose kontraktuesi i tij me artikuj që nuk janë furnizuar prej tij, dhe për arsye të disenjimeve në fjalë, të konstruksioneve dhe të modifikimeve ose të kombinimeve të tjera, është ngritur padi kundër Blerësit. Përveç kësaj, nëse për arsye të disenjës, instruksionit, të modifikimit ose të kombinimit, është ngritur padi ose proces kundër Shitësit, Blerësi do ta mbrojë Shitësin në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtën forcë që Shitësi ka rënë dakord të mbrojë Blerësin sipas dispozitave të këtij neni.

3. Ky nen është një deklaratë ekskluzive për të gjitha detyrimet e Palëve në lidhje me të drejtën e pasurisë intelektuale dhe shkeljet direkte ose indirekte të ligjit dhe për të gjitha mjetet ligjore të Blerësit në lidhje me çdo ankesë, padi ose proces që trajtojnë të drejtat e pasurisë intelektuale.

Respektimi i këtij neni, siç jepet këtu, do të përbëjë plotësimin e të gjitha detyrimeve të Palëve sipas Kontratës për sa i përket të drejtave të pasurisë intelektuale.

29. Kufizimi i përgjegjësisë

Blerësi shprehimisht pranon se në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë nuk do ta bëjë përgjegjës Shitësin, kompaninë e tij mëmë, vartësit e tij, filialet ose furnitorët e tij duke u nisur thjesht nga teoria e kompensimit, nëse nuk bazohet në Kontratë, për ndonjë gabim (duke përfshirë, neglizhencën ose përgjegjësi strikte), qoftë brenda garancisë ose ndryshe për çdo lloj dëmi indirekt, të veçantë, aksidental ose si pasojë (duke përfshirë, por jo të kufizohet te kjo, humbje të fitimit ose të ardhurave), dëmtimin ose humbjen e pasurisë ose të pajisjeve, humbje të fitimeve ose të ardhurave; humbje të përdorimit të pasurisë së Blerësit, të uzinës së tij, pajisjet ose sistemin; rritjen e shpenzimeve të çdo lloji; ose ankesat e klientëve të Blerësit.

Blerësi shprehimisht pranon se mjetet ligjore të dhëna këtu janë ekskluzive dhe se nën asnjë rrethanë detyrimet e grumbulluara të Shitësit, të kompanisë së tij mëmë, të vartësve të tij, të filialeve ose furnizuesve të tij, duke u nisur thjesht për përmirësimin e gjendjes, qoftë në bazë të Kontratës ose për gabime (duke përfshirë neglizhencën ose detyrimet strikte), qoftë brenda garancisë ose ndryshe, nuk do të tejkalojnë çmimin total paguar Shitësit sipas kësaj Kontrate. Ky nen do të ketë përparësi për çdo konflikt ose mospërputhje në dispozitat e kësaj Kontrate.

Kërkesat e këtij neni do të veprojnë edhe jashtë kushteve të Kontratës.

30. Dëmshpërblimi

Blerësi do ta dëmshpërblejë dhe do ta ruajë Shitësin të pacenuar nga ndonjë ose çdo lloj reklamimi dhe kërkesa të bëra nga çdo person ose person juridik të çfarëdo lloji natyre dhe në çdo kohë, kundër tij ose kompanisë së tij mëmë, vartësve të tij ose ndonjë nëpunësi, drejtori ose të punësuar nga ata që përmenden më sipër, nëse shitësi nuk është përgjegjës në lidhje me ndonjë vdekje, plagosje, dëmtim ose humbje duke përfshirë interesat, shpenzimet, koston dhe shpenzimet e tjera shoqëruese, të cilat ndodhin ose kanë tendencë të ndodhin, direkt ose indirekt, nga shfrytëzimi dhe funksionimi i pajisjeve, Produktet e Programit ose ndonjë material tjetër, livruar në këtë kuadër ose që lidhen me zërat e livruar të kësaj Kontrate. Detyrimet e shprehura në këtë nen do të aplikohen nëse vdekje të tilla, plagosje, dëmtime ose humbje shkaktohen ose ndihmohen nga neglizhenca e Shitësit, nga kompania mëmë ose vartësit e tij, nënkontraktuesit, furnizuesit dhe shitësit, ose ndonjë nëpunës, drejtor ose punonjës të mësipërm. Kërkesat e këtij neni do të veprojnë edhe jashtë kushteve të Kontratës.

31. Forca madhore

Çdo vonesë ose pengesë në realizimin e Kontratës që shkaktohet nga forca madhore jashtë kontrollit të Shitësit dhe/ose Blerësit ose nënkontraktuesit e tyre, furnizuesit dhe shitësit dhe jo nga ndonjë neglizhencë ose gabim, nuk do të konsiderohen shkelje ose shkelje të Kontratës. Shitësi dhe/ose Blerësi nuk do të konsiderohen përgjegjës për dëmtimet apo humbjet e ndodhura nga vonesa ose pengesa në realizimin e Kontratës. Forca madhore përfshin, por nuk kufizohet vetëm te këto: punët e Zotit, duke përfshirë stuhitë, përmbytjet, tërmetet dhe ciklonet; demonstratat, revolucionet, përlëshjet dhe kryengritjet

civile; zjarret; shpërthimet; aksidentet bërthamore; luftërat me ose pa deklarime, pushtimet, betejat dhe pirateritë; embargot, sëmundjet, karantinat dhe ndalimet e tregtisë; dhe veprimet ose ndërveprimet e qeverive ose të organeve ligjore, dhe Blerësi nuk do të ketë të drejtën të ngrejë një mbrojtje ndaj Forcës Madhore në lidhje me veprimet ose ndërveprimet e Qeverisë së Shqipërisë (ose të çdo organi të tij) në atë masë që këto akte të ndikojnë në realizimin e aktiviteteve të Blerësit. Sa më sipër, do të aplikohet edhe nëse shkaqe të tilla do të ndodhin në datën e hyrjes në fuqi të Kontratës ose të ndodhin edhe pasi Shitësi është vonuar në realizimin e detyrimeve të tij për shkaqe të tjera.

Shitësi dhe/ose Blerësi duhet të paraqesin ankesën për t'u shkarkuar nga pasojat e forcës madhore brenda 30 ditëve kur ndodh forca madhore. Shkarkimi i detyrimit do të kryhet duke bërë rregullime në grafikun e Kontratës, siç është shprehur te modifikimi i Kontratës. Ankesa është e vlefshme vetëm për grafikun e Kontratës.

32. Regjimi i kontrollit të eksportit

Kjo Kontratë i nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve që aplikohen në SHBA për kontrollin e eksporteve, për të cilat Blerësi është dakord të veprojë në përputhje të plotë, siç mund të aplikohen për mallrat, teknologjitë dhe Produktet e Programit të transferuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

Blerësi e ka të qartë se Shitësi mund t'i transferojë atij prodhime, teknologji dhe produkte programesh që u nënshtrohen ligjeve dhe rregullave për kontrollin e eksporteve në SHBA. Teknologjia, Produktet e Programeve dhe prodhimet direkt të këtyre teknologjive dhe Produkt Programesh që i janë livruar Blerësit sipas kësaj Marrëveshjeje nuk mund të shiten direkt ose indirekt, të livrohen, të transferohen, të devijohen ose në forma të tjera të dërgohen në destinacione të tjera ose te përdorues të veçantë.

Kërkesat e këtij neni do të veprojnë dhe janë të detyrueshme për Blerësin edhe pas përfundimit të Kontratës.

33. Materialet që siguron klienti

Blerësi do të sigurojë në kohën e duhur të gjitha materialet e ndërmjetme të nevojshme, duke përfshirë edhe dokumentacionin e kontrollit ndërmjetës, për të gjitha sistemet ekzistuese dhe të perspektivës të cilët Shitësi duhet të ndërlidhë sistemin e ri. Përveç kësaj, Blerësi do të sigurojë të gjitha pajisjet dhe materialet, si edhe asistencën dhe shërbimet, të cilat do të vendosen herë pas here nga Blerësi dhe Shitësi.

34. Kushtet e tjera të realizimit

Blerësi do të përgjigjet për të siguruar në kohën e duhur hyrjen e kërkuar nga Shitësi për në kantierin ekzistues ku do të instalohen pajisjet përkatëse. Blerësi do të sigurojë, sipas afateve, ndriçimin, energjinë elektrike, ujin, kushtet e mjedisit rrethues, si edhe shërbimet e tjera në sektorin e punës siç do të konsiderohen të nevojshme nga Shitësi për të realizuar një instalim efektiv. Blerësi do të marrë menjëherë dhe siç duhet të gjitha masat e nevojshme për të siguruar një vazhdimësi në realizimin e grafikut të projektit, ku përfshihet edhe shqyrtimi në kohë dhe kthimi i dokumenteve që janë dhënë për t'u shqyrtuar, siç specifikohet këtu. Të gjitha shërbimet e mësipërme, materialet, pajisjet dhe veprimet në mjediset ekzistuese të Blerësit do t'i vihen në dispozicion Shitësit pa pagesë, ose tarifë ose ndryshim të çmimit të kontratës.

35. Dokumentacioni teknik

Dokumentacioni teknik i livruar në kuadër të kësaj kontrate është e drejtë autorësie e Shitësit ose ndonjë pale të tretë, të cilët janë nënkontraktues, furnizues ose shitës të Shitësit. Riprodhimi i dokumentacionit teknik nga Blerësi do të lejohet vetëm nëse autorizohet më parë në mënyrë të veçantë me shkrim nga Shitësi. Pjesë të dokumentacionit teknik mund të jenë objekt i kufizimeve të tjera në përdorim, siç është pasuria intelektuale e licencuar e Shitësit ose licencues të tjerë.

36. Shërbimet inxhinierike

Në çdo kohë dhe në opsion vetëm të tij Blerësi mund të nxjerrë urdhra për detyrat e shërbimeve inxhinierike për Shitësin për të kryer detyrat e tij lidhur me këto shërbime teknike nëse nuk shprehet ndryshe në kontratë. Këto urdhra do të përmbajnë detyrat e caktuara që do të kryhen, të shprehura në orë pune, një kufi të caktuar që autorizon të harxhohen shpenzime të caktuara dhe një pasqyrë të kërkesave.

Shitësi do të fillojë kryerjen e detyrave menjëherë pasi t'i marrë këto porosi. Asnjë urdhër nuk do të jetë i vlefshëm për Shitësin nëse i kërkohet të veprojë në kundërshtim me kushtet e kësaj Kontrate ose të shkelë ligjet e SHBA-së ose ligje të tjera që janë në fuqi. Asnjë urdhër nuk do të jetë i vlefshëm për Shitësin nëse i kërkohet të transferojë ndonjë aset të pasurisë intelektuale nëpërmjet shitjeve ose me mënyra të tjera, me përjashtim kur ka licencë të lëshuar nga Shitësi si pronar ose agjent i autorizuar ose licencues i pronarit. Faturat për detyrat e shërbimeve inxhinierike do të përgatiten nga Shitësi 30 ditë pas fillimit të punës për zbatimin e detyrave përkatëse dhe, më vonë, në rastet e zgjatjes së punës, në çdo interval 30 ditor. Blerësi do t'i paguajë këto fatura në vlef të plotë brenda 30 ditëve pas marrjes së tyre.

37. Transferimi i teknologjive

Shitësi do të merret me implementimin e transferimit të teknologjisë në përputhje me planin për transferimin e teknologjisë që do të bihet dakord nga të dyja Palët. Ky plan mund të trajtojë çështjet e trajnimit, të asistencës, arsimimit, lehtësitë e ndryshme dhe grafikët. Çdo ndryshim që i bëhet këtij plani mund të konsiderohet nga Shitësi si ndryshim rregullor sipas nenit 17.

38. Kalimi i të drejtave

Kjo Kontratë mund të lejojë përfitime dhe të jetë e detyrueshme për pasardhësit përkatës dhe personat e caktuar nga Palët këtu, por nuk mund të kalojë të gjitha të drejtat ose një pjesë të tyre, vetëm me vullnetin e Blerësit, pa marrë më parë miratimin me shkrim nga Shitësi. Shitësi mund të atribuojë ndonjë të drejtë, të transferojë ose të krijojë ose të lejojë të vazhdojë ndonjë detyrim, administrim, sigurim ose interesa të tjera të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë të drejtë ose licencë të dhënë me anën e kësaj tek ose në favor të organizatës Lockheed Martin.

39. Anulimi

1. Secila Palë, në bazë të dispozitave të këtij neni, nëpërmjet një njoftimi, i quajtur njoftim "Për mospërbushje detyrimi", i bën të ditur Palës tjetër (më poshtë referuar si "Shpërdoruesi") anulimin e gjithë Kontratës ose pjesë të saj nëse Shpërdoruesi: (a) nuk është në gjendje të plotësojë dispozitat e Kontratës ose nuk arrin të bëjë përparime dhe vë në rrezik realizimin e kësaj Kontrate sipas kushteve dhe afateve të përgjithshme dhe nëse në asnjë rrethanë nuk përmirëson gjendjen ose të marrë masa për përmirësimin e menjëhershëm dhe këmbëngulës të kësaj mospërbushjeje brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër ose për periudha më të gjata sipas njoftimit të Palës tjetër; (b) kërkon ose miraton caktimin e një kujdestari, administratori ose likuidatori për atë vetë dhe pasurinë e tij; (c) nuk është në gjendje ose pranon me shkrim paaftësinë e tij për të paguar borxhet e tij; (d) bën një kalim të përgjithshëm në favor të kreditorëve; (e) deklarohet falimentimi i tij; (f) plotëson vullnetarisht deklaratën e falimentimit, një petition ose përgjigje, duke kërkuar një riorganizim të ri ose një risistemim tjetër me kreditorët; ose (g) kur ndërmerret veprime që kanë të njëjtin efekt si ato më sipër.

2. Nëse një nga Palët anulon Kontratën për mospërbushje detyrimi, asnjë nga Palët nuk do të kërkojë sigurimin e ndonjë pagese siç shprehet në këtë nen dhe është përgjegjës për Palën tjetër për të gjitha humbjet, dëmtimet, shpenzimet dhe harxhimet sipas ligjit, të shkaktuara për arsye të mospërbushjes së detyrimeve ose të ngjarjeve të tjera mbi të cilat u bazua edhe njoftimi për mospërbushjen e detyrimeve.

3. Në rast të anulimit të njëanshëm të kësaj Kontrate për mospërbushje detyrimi iniciuar nga Blerësi, Shitësi do të vazhdojë realizimin e Kontratës në atë masë që të mos anulohet dhe nuk do të ndalojë, të zgjatë ose të pengojë ndonjë aspekt ose pjesë të Kontratës që presin të vendoset dhe të zgjidhet ndonjë mosmarrëveshje ose konflikt.

4. Në rast të anulimit të kësaj Kontrate iniciuar nga Blerësi për mospërbushje detyrimi, përveç të drejtave që gëzon sipas Kontratës ose ligjit, Blerësi mund t'i kërkojë Shitësit të transferojë titullin dhe t'i japë Blerësit çdo pjesë të Projektit që është blerë direkt nga Shitësi për këtë Kontratë, por nuk është livruar e marrë në dorëzim para anulimit.

5. Pagesa ose kredia e bërë nga Blerësi për çdo pjesë të Projektit dhe që është livruar dhe marrë në dorëzim nga Blerësi, do të vlerësohet e gjitha dhe do të vendoset në bazë të çmimit të Kontratës.

40. Legjislacioni rregullues dhe vendi i zgjidhjes

Kjo Kontratë do të interpretohet në bazë të ligjeve të Anglisë dhe të Uellsit, me përjashtim të

dispozitave në lidhje me konfliktet e ligjeve. Palët bien dakord që Konventa e Kombeve të Bashkuara për Shitjet Ndërkombëtare të mallrave (UNCISG) nuk do të zbatohet për këtë Kontratë ose për interpretimin e dispozitave të saj.

41. Arbitrazhi

1. Palët do të përpiqen që të zgjidhin çdo mosmarrëveshje që lind ose që ka lidhje me këtë Kontratë ose që ka të bëjë me shkelje pa ndonjë arsye të kësaj Kontrate brenda 30 ditëve nga koha kur njëra Palë njofton palën tjetër për ekzistencën e mosmarrëveshjes ose në afate të tjera që Palët mund të bien dakord.

2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet siç shprehet në paragrafin 1, mosmarrëveshja do t'u adresohet për zgjidhje niveleve më të larta të menaxhimit sipas organizimit që ka secila Palë. Nëse edhe nivelet më të larta të drejtimit nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda 30 ditëve ose për afate të tjera që mund të vendoset bashkërisht, atëherë mosmarrëveshja do të zgjidhet nga Arbitrazhi i detyrueshëm në përputhje me klauzolat e këtij Arbitrazhi.

3. Në rast se ndonjë konflikt ndërmjet Palëve nuk është zgjidhur e pranuar nga Palët siç shprehet edhe më sipër, atëherë do të adresohet për t'u vendosur nga një ndërmjetës i paanshëm që administrohet nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë në Zvicër dhe mund të mbahet në Tiranë, Shqipëri.

4. Çdo konflikt ndërmjet Palëve që nuk është zgjidhur siç shprehet më sipër dhe Palët nuk janë të kënaqura, atëherë ai do të zgjidhet nga Arbitrazhi i detyrueshëm që administrohet nga Dhoma e Tregtisë në Zvicër sipas rregullores së tij për Arbitrazhin tregtar dhe procedurat shtesë për konflikte të mëdha e komplekse, dhe gjykimi i marrë përsipër nga arbitrat mund të regjistrohet në çdo gjykatë sipas juridiksionit.

5. Brenda 15 ditëve pasi ka filluar arbitrimi, secila Palë do të caktojë një person që të veprojë si arbitër dhe këta të dy që u zgjedhën do të zgjedhin një arbitër të tretë brenda 10 ditëve nga data e emërimit të tyre. Nëse arbitrat e përzgjedhur nga Palët nuk arrijnë të zgjedhin arbitrin e tretë, atëherë arbitri i tretë do të caktohet nga autoritetet përkatëse të Arbitrazhit. Nëse Palët nuk arrijnë të zgjedhin dy arbitrat brenda afatit të specifikuar, atëherë të tre arbitrat do të caktohen nga Shoqata e Arbitrazhit në bazë të Rregullores për Arbitrazhin Tregtar. Para fillimit të seancave, secili arbitër i emëruar do të bëjë betimin dhe do të shprehë paanshmërinë.

6. Vendimi do të merret me shkrim dhe do të firmoset nga shumica e arbitrave dhe do të përmbajë edhe një deklaratë në lidhje me shpjegimet për mënyrën e zgjidhjes së konfliktit. Pastaj ata do të shënojnë shpërblimin e tyre dhe pjesën e secilës Palë në USD.

7. Brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit (i cili nuk është i detyrueshëm nëse është bërë apelimi), secila nga Palët mund të njoftojë autoritetet e Arbitrazhit të detyrueshëm nëse ka për qëllim të apelojë në një gjykatë tjetër arbitrazhi, i cili vepron si arbitrazhi i parë. Gjykatës së apelit i jepet e drejta ta adaptojë si të sajën vendimin e parë, mund ta modifikojë atë dhe të paraqesë vendimin e saj si vendim të parë. Gjykata e apelit nuk do të modifikojë ose të zëvendësojë vendimin e parë kur nuk ka gabime të qarta ligjore ose gabime të qarta e bindëse të faktuara. Vendimi i apelit është përfundimtar dhe i detyrueshëm dhe gjykimi mund të regjistrohet në çdo gjykatë që është në juridiksion.

8. Secila Palë do të përballojë shpenzimet dhe harxhimet e veta në mënyrë të barabartë për pagesën e arbitrave dhe tarifat administrative të arbitrazhit, duke përfshirë edhe apelimin, nëse do të ketë apelim të tillë.

9. Vendi për arbitrimin e fundit do të jetë Gjeneva në Zvicër në bazë të ligjeve të Anglisë dhe të Uellsit, duke përjashtuar dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Shitjen Ndërkombëtare të mallrave. Në arbitrazh do të përdoret gjuha angleze.

10. Gjykimi sipas vendimit të marrë mund të përmbajë kompensimin e dëmit për secilën Palë, por në asnjë rrethanë nuk do të autorizojë, të kryejë e të paguajë dëmtime të veçanta, të qëllimshme, shumëpalëshe ose pasojë e diçkaje, duke përfshirë këtu edhe fitimet e humbura.

11. Palët bien dakord dhe pranojnë se ato veprojnë me atributet tregtare në ekzekutimin dhe implementimin e kësaj Kontrate. Duke u nisur se si e sa një Palë i jep të drejtë vetes të veprojë me imunitete superiore ose diçka të përafërt me të, në lidhje me çdo ankesë ose proces dhe që lidhen me

detyrimet që lindin nga kjo Kontratë, kësaj Pale në mënyrë të prerë i hiqet ky imunitet dhe duhet të pranojë që të mos shfrytëzojë imunitete të tilla qoftë në lidhje me juridiksionin e ndonjë gjykate ose ndonjë procesi ku ajo është përfshirë ose ka lidhje me asetet e saj, borxhe, burgosje (qoftë e paragjykuar) ose ekzekutimi i ndonjë vendimi gjykate.

42. Ndryshimi i rrethanave

Kategori të caktuara në ndryshimin e rrethanave influencojnë në të drejtat dhe detyrimet e Shitësit në këtë Kontratë, prandaj në këtë aspekt Shitësi nuk merr përsipër asnjë risk.

Këto kategori janë:

a. Ndryshimi i ligjit.

b. Ndryshimet në vendosjen e taksave përkatëse.

c. Direktivat e një Organi kompetent që prekin si Shitësin edhe/ose Blerësin.

Nëse ndodh një nga këto ndryshime rrethanore, ato do të konsiderohen ndryshim rregull, i cili lëshohet në përputhje me nenin 17.

Shitësi nuk përgjigjet për ndonjë mospërputhje ose vonesë në plotësimin e dispozitave të Kontratës në atë shkallë që kjo mospërputhje ose vonesë është rezultat direkt ose indirekt i këtyre ndryshimeve rrethanore, pavarësisht se ndryshime të tilla prekin atë vetë, furnizuesit e tij, ndonjë nga punonjësit e tij, nëpunësit ose agjentët e tij.

43. Zgjidhjet ligjore ekskluzive

Palët synojnë që të drejtat e tyre respektive, detyrimet dhe përgjegjësitë që jepen në këtë Kontratë të jenë të plota e të hollësishme për të dyja Palët. Prandaj, rrugët e zgjidhjeve që janë shprehur në këtë Kontratë dhe në ndonjë dokument tjetër që i shtohet kësaj do të jenë zgjidhjet e vetme dhe ekskluzive për detyrimet që një Palë ka ndaj Palës tjetër që lindin nga kjo Kontratë ose kanë lidhje me atë, duke përfshirë çdo përfaqësim, garanci, veprim të ndërmarrë në lidhje me këtë, pavarësisht se ndonjë zgjidhje mund të jetë shprehur ndryshe në ligj ose nga drejtësia. Ky nen nuk kufizon masat kundër vjedhjeve.

44. Ndryshimi i kushteve të punës

Shitësi e di se nuk ka ndonjë detyrim për të ndërmarrë ndonjë studim të plotë e aktual në lidhje me kushtet fizike të vendit të punës, siç quhet Mjedisi i Faktuar. Por nëse këto kushte ndryshojnë rrënjësisht nga koha e studimit deri në kohën kur fillojnë nga puna elemente të veçanta të Projektit, atëherë ky ndryshim do të interpretohet sipas Shitësit si ndryshim rregull në përputhje me nenin 17.

Përveç kësaj, nëse kushtet dalin se janë në mënyrë substanciale të ndryshme nga ato që janë evidentuar në studimin e zonës, të cilat do të kenë një influencë të kundërt dhe të rëndësishme për mundësitë e Shitësit në realizimin e Projektit sipas planeve të hartuara, Shitësi, në opsion vetëm të tij, do t'i konsiderojë këto ndryshime Ndryshime Rregull në përputhje me nenin 17.

45. Të përgjithshme

Kjo Kontratë, duke përfshirë edhe anekset e referuara këtu, përmban marrëveshjen dhe mirëkuptimin e plotë të Palëve, zëvendëson të gjitha deklaratat e mëparshme, mirëkuptimet dhe marrëveshjet e ndryshme të bëra me gojë ose me shkrim në lidhje me çështjet e objektit të kësaj Kontrate, me përjashtim të ndonjë dokumenti me shkrim që do të nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve më vonë. Titujt e paragrafëve në këtë material janë shkruar vetëm për lehtësi dhe në asnjë rast nuk kufizojnë objektin e kësaj Kontrate. Nëse ndonjë afat, dispozitë, marrëveshje ose kusht tjetër i kësaj Kontrate bëhet i pavlefshëm ose i pazbatueshëm për çfarëdo arsye, dispozitat e tjera do të vazhdojnë të jenë e të veprojnë me fuqi të plotë sikur kjo Kontratë të ishte nënshkruar pa pjesën e pavlefshme dhe dispozitat që mbetën në fuqi do të interpretohen në atë mënyrë që të kenë të njëjtin fuqi dhe efekt për Palë edhe pa dispozitat e eliminuara.

Korporata Lockheed Martin

Drejtor i Përgjithshëm i Aviacionit Civil

Qeveria e Shqipërisë

Nga _____

Nga _____

Titulli _____

Titulli _____

Datë _____

Datë _____

Kushtet dhe Afatet e Kontratës së Projektit për Menaxhimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (NAMP)

ANEKSI 1 Skema e Kërkesave dhe Çmimet

Versioni VI.5

Numri i Referencës: ALBGEN-0025

22 nëntor 2002

ANEKSI 1 (VAZHDIM) Plani i kërkesave dhe Çmimet

Faza e parë

Të ndihmohet Qeveria shqiptare për të siguruar financimin tregtar. Do të sigurohen mallrat dhe shërbimet e nevojshme për të mundësuar instalimin e sistemit fillestar të automatizuar, i cili do të bëjë të mundur që në Fazën e dytë të kalohet në sistemin e kontrollit me radarë. Do të sigurojë asistencë për funksionimin e Trafikut Ajror për të realizuar mundësinë e kontrollit me radarë brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës, duke shfrytëzuar kushtet aktuale të kontrollit. Do të modifikohet dhe do të rregullohet ndërtesa ekzistuese e ACC/APP për të mundësuar instalimin e sistemit fillestar të automatizuar. Do të përfundojë grumbullimi i të dhënave për një Kullë të re vëzhgimi të ACC/APP. Do të realizohen detyrat e ndryshme në lidhje me funksionimin e Trafikut Ajror. Mendohet që kjo punë të financohet direkt nga fitimet e NATA-es në përputhje me ligjin shqiptar për taksat.

.....\$3.295.000

Faza e dytë

Do të sigurohet sistemi fillestar i automatizuar, i cili do të mundësojë të kalohet në fazën e kontrollit me radarë që të jetë gati për trafikun e Lojërave Olimpikë në verën e vitit 2004, duke përfshirë hapjen e një sektori të ri në hapësirën aktuale. Do të disenjohet dhe do të ndërtohet një Kullë e re vëzhgimi për ACC/APP. Do të modernizohen nënsistemet e automatizuara të komunikimit, të fluturimit, të survejimit dhe të drejtimit të Trafikut Ajror. Do të përfundojnë detyrat e ndryshme në lidhje me operimin e Trafikut Ajror. Do të livrohen mallrat e nevojshme me synimin për të funksionuar si një qendër virtuale për Qiellin e Vetëm Evropian (Single Sky). Do të ngrihet një zyrë për menaxhimin e projektit me personel shqiptar, e cila do të marrë në dorëzim teknikën dhe do të aftësohet. Mendohet që fondi për këtë punë do të mbulohet nga financimi tregtar. Propozimi ynë për të mos tejkaluar çmimin e Fazës së dytë bëhet me qëllim se, me harxhimin e financimit tregtar dhe shpenzimet për procedurat e sigurimit, mund të dalë e nevojshme të bëhen modifikime.

..... \$29.682.807

ANEKSI 1 (VAZHDON) Përmbledhje e draftit të Çmimeve për Shqipërinë sipas CLIN

CLIN	Emërtimi	Totali	Faza e parë	Faza e dytë
------	----------	--------	-------------	-------------

Totali			
FI02 Asistencë për sigurimin e financimit tregtar			
SU03 NEW ATM Sistemi i automatizimit			
BL 10 Rregullimi i ndërtesës ekzistuese			
BL07 Ndërtesa për Kullën e re të ACC			
FI01 Asistencë për menaxhimin financiar për DGCA/NATA			
ORO05 Ndhma për PMO			
AT10 Të gjitha detyrat e tjera			
CO03 VCS e re			
C002 Instalimi i pajisjeve për radiot në distancë			
CO05 UHF/VHF transceivers			
CO07 VHF SATCOM			
NA03 Enroute DVOR			
NA04 MT DVOR dhe ILS të aeroportit			
SU02 Terminali për PSR			
OT01 Pajisjet për Kullën e re			
OT02 Përmirësimi i pajisjeve MET			
OR07 Zyra shqiptare PMO			

Kushtet dhe Afatet e Kontratës së Projektit për Menaxhimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (NAMP)

ANEKSI 2 PLANI I PUNËS (SoW)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PROJEKTI PËR MODERNIZIMIN E HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE (NAMP)

Versioni V 2.1
 Numri i referencës: ALBGEN02-0025
 22 nëntor 2002
 Lockheed Martin Air Traffic Management
 9211 Corporate Boulevard
 Rockville, Maryland 20850
 USA

KONTROLLI I DOKUMENTEVE TË PLANIT TË PUNËS (SOW) HISTORIKU I NDRYSHIMEVE

Ripunimet	Data e botimit	Përmbledhje e ndryshimeve
Versioni 0.1	tetor 2002	Drafti fillestar
Versioni 1.0	4 nëntor 2002	Versioni bazë
Versioni 2.0	6 nëntor 2002	Versioni i negociuar
Versioni 2.1	16 nëntor 2002	Versioni i miratuar LM

SHKURTIMET

CS	/	Area Control Services – Shërbimet për Kontrollin e Zonës
PP	/	Approach and Departure Control Services-shërbimet për kontrollin e afrimit dhe të largimit
MA	/	Reliability, Maintainability and Availability- Mbështetja, mirëmbajtja dhe disponueshmëria
	/	Air Traffic Control-Trafiku i Kontrollit Ajror

TC		
TSA	A	Air Traffic Services Authority- Organi përgjegjës për shërbimet e Trafikut Ajror
AA	C	Civil Aviation Authority- Organi përgjegjës për Aviacionin Civil
CDS	C	Call Sign DataBase System-Sistemi i të dhënave bazë për shenjat e thirrjes
M	C	Configuration Management-Menaxhimi i konfiguracionit
MP	C	Configuration Management Plan-Plani për menaxhimin e konfiguracionit
OTS	C	Commercial Off the Shelf- E paprojektuar për tregti
WP	C	Controller Workstation Position-Funksionet e punonjësve të kontrollit
P	I	Display Processor- Procesues i ekranit
AT	F	Factory Acceptance Testing- Testimi në fabrikë për miratimet
DS	I	Information Display System-Sistemi për paraqitjen e informacionit
FAT	I	Internal factory Acceptance Test-Testi i brendshëm i fabrikës për miratim
P	I	Installation Plan-Plani i Instalimeve
PR	I	Intellectual Property Right-E drejta e pasurisë intelektuale
MATM	I	Lockheed Martin Air Traffic Management-Menaxhimi i Trafikut Ajror Lockheed Martin
RU	I	Line Replaceable Unit-Grupet e zëvendësueshme të linjës
AC	M	Months After Contract-Muajt pas Kontratës
TBF	M	Mean Time Between Failures-Dështimet ndërmjet kohës diellore
TTR	M	Mean Time To Repair-Koha diellore për riparim
AMP	M	National Airspace Modernization Project-Projekti për modernizimin e hapësirës ajrore.
DS	C	Operational Display System-Sistemi i ekranit operacional
MO	F	Project Management Office-Zyra për menaxhimin e Projektit
A	C	Quality Assurance-Garantimi i cilësisë
P	C	Quality Plan-Plani i cilësisë
DPSD	F	Radar Data Processing and Display System-Sistemi për paraqitjen dhe përpunimin e të dhënave të radarit
P	F	Radar Processor-Procesori i radarit
SS	F	Radar Site Simulator-Simulatori i radarit në vendin e punës
TQC	F	Real Time Quality Check-Kontrolli i saktësisë së kohës reale
AT	S	Site Acceptance Testing-Testimet për miratimet në vendin e punës
DF	S	Site Development Facility-Kushtet për organizimin e vendit të punës

QP	§	Software Quality Plan-Plani i cilësisë të softwar-it
WP	§	Support Workstation Position-Funksioni i punonjësve ndihmës
DA	7	US Trade and Development Agency-Agjencia Amerikane për tregtinë dhe zhvillimin
DS	7	Test and Development System-Sistemi i testimeve dhe i përpunimeve
MCS	7	Technical Monitor and Control System-Sistemi i kontrollit dhe i monitoruesit teknik
P	7	Test Plan-Plani i testimeve

1. Hyrje

Gjatë viteve 1997-2000 Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil (DGCA) dhe Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror (NATA), punoi me Eurokontrollin për të përfunduar Planin Kryesor për Menaxhimin e Trafikut Ajror (MATMP), i cili përcaktonte modernizimin e infrastrukturës së nevojshme për të rritur në mënyrë të dukshme kapacitetet e hapësirës ajrore. Në vitin 2001 Republika e Shqipërisë, nëpërmjet DGCA, kontrakttoi me Lockheed Martin për Menaxhimin e Trafikut Ajror (LMATM) për të kryer Studimin e Fizibilitetit për Projektin për Modernizimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (NAMP), i cili do të rekomandonte si të financohej dhe të implementohej modernizimi i infrastrukturës së nevojshme i MATMP për të rritur në mënyrë të sigurt kapacitetet e hapësirës ajrore. Në tetor të vitit 2001 Lockheed Martin i dorëzoi NAMP Studimin e Fizibilitetit, ku rekomandohej të kontrakttohej me një furnizues të huaj për Sistemet në Menaxhimin e Trafikut Ajror për të ndihmuar RSH-së të siguronte financimin tregtar dhe të implementonte modernizimin e Projektit. Meqenëse LMATM ofroi vleftën më të mirë për këtë zgjidhje dhe paraqiti një plan të besueshëm, si edhe një çmim konkurrues, RSH-së i kërkoi LM-it të paraqesë ofertën e plotë, e cila do të shërbejë si bazë për Kontratën ndërmjet RSH-së dhe LM-it. Ky Raport Pune përshkruan objektivat e Kontratës që është rënë dakord. Në këtë Raport Pune LMATM cilësohet si Shitësi dhe Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga DGCA, cilësohet si Blerësi. Furnizuesit janë nënkontraktues ose shitës që do të kontraktohen nga LMATM në bashkëpunim me DGCA për të siguruar produktet dhe shërbimet e nevojshme.

2. Objekti

Ky Raport Pune përshkruan punën që duhet bërë, produktet, shërbimet e zërat që do të livrohen dhe përgjegjësitë që i ngarkohen LMATM-së si Kontraktues kryesor për NAMP-in.

Shitësi do të përgjigjet për përgatitjen e të gjitha disenjimeve, për dokumentacionin, për akuizitën, për prodhimet, për livrimet, për testimet dhe për integrimin e produkteve të livruara me shërbimet në përputhje me kërkesat e evidentuara në këtë material. Detyrat për instalimin do të vendosen si detyra të veçanta. Shitësi do të sigurojë asistencë për marrjen në dorëzim pas instalimit, siç përcaktohet në Kontratë.

Shitësi do të japë asistencë për punimet e përcaktuara si më poshtë:

Të organizojë dhe të drejtojë shqyrtimet për menaxhimin e programit (PMR).

Të organizojë e të drejtojë mbledhjet për programet teknike (TIM).

Të sigurojë udhëheqjen teknike për zgjidhjen e çështjeve teknike.

Të japë ndihmë teknike gjatë integritit të sistemeve të Shitësit.

Të kryejë analiza të sigurta, dhe të vështira në mbrojtje të mjedisit.

Të ndihmojë në detyrat për operimin e trafikut ajror.

Të ndihmojë në detyrat për burimet njerëzore.

Të ndihmojë në detyrat për menaxhimin financiar.

Të ndihmojë në detyrat për legjislacionin.

3. Dokumentet shoqëruese

Raporti i Punës shoqërohet me dokumentet e mëposhtme, të cilët sigurohen nga Shitësi, sepse

kanë lidhje me punën që do të kryhet.

Emërtimi i dokumenteve: Data

Studimi i Fizibilitetit nga Lockheed Martin për Menaxhimin e Trafikut Ajror, tetor 2001

Plani kryesor për Menaxhimin e Trafikut Ajror, ripunuar në shtator 2000, mars 2002.

4. Kërkesat

4.1 Kërkesat

Shitësi do të sigurojë produkte dhe shërbime për të modernizuar infrastrukturën e shërbimeve për fluturimet ajrore në Shqipëri (ANA), siç përshkruhet në këtë Kontratë. Kjo do të përfshijë asistencë në menaxhim, inxhinierikë, financiarë, burimet njerëzore, organizative, sigurinë dhe çështje të legjislacionit.

4.1.1 Funksionale

Shitësi do të ndihmojë në Arkitekturën e Sistemit, Sistemin inxhinierik dhe Sistemet e integritetit për të arritur në modernizimin e infrastrukturës së ANS-së që ndërrohet me standardet e eurokontrollit dhe ICAO-së.

4.1.2 Konfiguracioni

Shitësi do të ndihmojë në kontrollin e sistemit të konfiguracionit të ANS-së për të siguruar një integritet dhe ndërrohet me sukses të sistemit.

4.2 Livrimet

Shitësi do të livrojë produktet dhe shërbimet që përshkruhen në këtë Raport në përputhje me shtesën A, grafiku i livrimeve.

4.2.1 Hardware/Software/Firmware

Shitësi do të livrojë dhe do të ndihmojë me instalimin, siç përcaktohet në planet e Projektit për livrimin e artikujve.

4.2.2 Dokumentacioni

4.2.2.1 Manualet për operimin dhe mirëmbajtjen

Shitësi do të livrojë dokumentacionin standard shoqëruar me zërat e caktuar. Këtu përfshihen Manualet COTS plus ndonjë dokumentacion shtesë që normalisht livrohet me mallin. Kur është e nevojshme, dokumentacioni do të jetë në dy kopje, si vizatimet për ndërtim dhe manualet teknike (për funksionimin, mirëmbajtjen, shërbimin, pjesët e ndërrimit dhe diagramet për lidhjet elektrike) për të gjitha pajisjet. Një kopje e të gjitha manualeve do të dërgohet në zyrat e LMATM-së në Rockville dhe një komplet në terren me livrimet hardware për Blerësin. Nëse do të jetë e mundur, 2 fotokopje të të gjithë dokumentacionit të livruar do t'i dërgohet me CD-ROM. Formatit do të bihet dakord ndërmjet LMATM-së dhe furnizuesve, por Microsoft Word është formati më i preferuar.

Për livrimet e kërkuara, Manualet teknike standarde duhet të përfshijnë, sipas formatit të furnizuesit, si më poshtë:

Përshkrimin e funksionimit në nivel të lartë.

Të dhëna fizike.

Instruksione për vendosjen dhe funksionimin.

Instruksione për mirëmbajtjen e nivelit të kantierit dhe përshkrimet LRU.

Diagramet ndërlidhëse.

Skemat për nivelin e komponentëve për pajisje të veçanta.

Guidë funksionale për përdoruesin.

Formate dhe protokolle për të gjitha programet (interface) - nëse kërkohet.

4.2.2.2. Materialet për trajnimin

Shitësi do të sigurojë materialet e duhura për trajnim të shoqëruara me të gjitha kurset e trajnimit dhe do të shënojë në propozimin e furnizuesit se çfarë materiale duhet të vihen në dispozicion. Përveç kësaj, manuale teknike do t'u jepen edhe studentëve gjatë kurseve të kualifikimit.

4.2.2.3 Riprodhimi

Shitësi do t'i japë Blerësit, siç është vendosur me furnizuesit, të drejtën të riprodhojë pa ndonjë shpenzim shtesë të gjithë dokumentacionin e livruar me përjashtimin dhe kufizimin që të përdoren vetëm

nga Projekti shqiptar.

4.3 Garantimi i cilësisë

4.3.1. Programi për sigurimin e cilësisë

Shitësi do të operojë dhe mbajë një Program për sigurimin e cilësisë në përputhje me ISO9001. Shitësi do ta implementojë programin e tij për sigurimin e cilësisë në përputhje me Manualin për Cilësinë. Shitësi do të sigurojë përputhjen me të gjitha kërkesat për cilësinë dhe ato kontraktuese dhe do të garantojë cilësinë për të gjitha produktet dhe shërbimet e kërkuara nga Kontrata për afatin e prokurimeve. Para livrimit të secilit produkt, Shitësi do të verifikojë përputhjen me të gjitha kërkesat e Kontratës. Shitësi do të japë pikat e kontaktit për garantimin e cilësisë për t'u lidhur me Blerësin.

4.3.2 Kontrollat dhe auditimet (kontrolli financiar) e LMATM-së

Shitësi do të kryejë kontrolle dhe/ose auditime kur është e nevojshme për të përcaktuar saktësinë e furnizuesit me programin QA (garantimi i cilësisë). Shitësi do të ndërmarrë masat e duhura për korrigjimet për zgjidhjen në kohën e duhur të mospërputhjeve të diktura.

4.3.3 Shënime për cilësinë

Shitësi do të mbajë shënime për cilësinë në përputhje me kërkesat e ISO9001 për të gjithë punën e bërë në sistem, aktivitetet hardware dhe software për të demonstruar arritjet e cilësive të kërkuara dhe funksionimin me efektivitet të menaxhimit të cilësisë. Shitësi do t'i mbajë të gjitha regjistrimet për cilësinë në bazë të sistemit të cilësisë të dokumentuar nga Shitësi.

4.4 Menaxhimi i konfiguracionit

Shitësi do të implementojë një Program për Menaxhimin e Konfiguracionit, i cili do të sigurojë kontrollin formal dhe do të kërkojë nëpërmjet programit. Praktikën për Menaxhimin e konfiguracionit do të plotësojnë synimet e kërkesave të ISO CM-së (ISO 10007-1995). Praktikën CM të Shitësit do të sigurojnë një zhvillim të kontrolluar, ndjekje të problemeve të strukturuar, fiksime të avionit dhe dokumentacionin shoqërues.

Shitësi do të vendosë, do të mbajë dhe do të raportojë gjendjen e të gjitha pajisjeve të livruara dhe të montuara sipas këtij Raporti. Shitësi do të përgatisë edhe një raport për livrimet e bëra dhe veprimet për mirëmbajtjen e pajisjeve, duke përfshirë sa më mirë informacionet e mëposhtme:

- Numri rendor i blerjes, numri i ngarkimit, numri i artikullit sipas Kontratës.
- Numrin identifikues të prodhimit.
- Tipin e makinës/numri modelit.
- Numri i pjesës.
- Numri i serisë.
- Niveli i kontrollit.
- Pamja, opsionet e tjera.
- Numri i pjesës/pamjes.
- Numri i serisë/pamjes.
- Niveli i kontroll/pamjes.
- Informacionin për instalimin me instruksionet përkatëse, data e instaluar dhe vendi i instaluar.
- Sistemi i instaluar.
- Informacionet për testimet.
- Masat e duhura për mirëmbajtjen.

Formati i raportit për njoftimin e livrimeve do të jetë ai i Shitësit, i përshtatshëm për të dokumentuar veprimet e bëra për livrimin dhe mirëmbajtjen. Blerësi duhet të konfirmojë marrjen e dokumentit të livrimeve. Ai mund të dërgohet nëpërmjet medias elektronike.

4.5 Marrja në dorëzim

4.5.1 Të përgjithshme

Ky seksion evidenton kërkesat e nevojshme për verifikimin për pranimin e nënsistemeve.

Filozofia e verifikimit, proceset, përgjegjësitë dhe procedurat do të përshkruhen në Planin e Shitësit për testet. Verifikimi i të gjitha kërkesave do të bëhet sa më herët që të jetë e mundur në procesin e prokurimit. Interface-et e sistemeve do të verifikohen si pjesë e përpjekjeve të përgjithshme të

verifikimit. Nivelet e verifikimit dhe metoda për çdo kërkesë do të përcaktohen në planin e testeve. Nivelet dhe metodat e evidentuara do të konsiderohen si minimale.

4.5.2 Plani i testeve

Shitësi do të përgatisë planin e testeve për shumicën e nënsistemeve të livruara dhe do ta dorëzojë atë brenda 90 ditëve pas nënshkrimit të Kontratës. Meqenëse disa nënsisteme kryesore do të porositen, livrohen dhe do të instalohen në vitin e tretë dhe të katërt të Kontratës, Plani i testeve do të jetë evolues dhe do të përfshijë Planet e testeve për livrimet e mëvonshme të nënsistemeve dhe Plane testesh në versione të tjera. Plani i testeve do të përfshijë minimalisht sa më poshtë:

Grafikun e aktiviteteve, testin e pranimi në fabrikë (FAT), integrimin e sistemit, testimet dhe testin e pranimi në terren (SAT)

Evidentimin e niveleve të verifikimit dhe metodat për nënsistemet kryesore të livruara.

Nivelet e verifikimit përfshijnë pajisjet (FAT), integrimin (pajisjet dhe testimin e integritetit) dhe terrenin (SAT).

4.5.3 Testi i pranimi në fabrikë

Shitësi do të kërkojë të kryhet testi i pranimi në fabrikë (FAT) ose në mjediset e fabrikës së furnizuesit, para se këto nënsisteme të livrohen. Procedurat që aplikohen për testin e pranimi në fabrikë dhe të gjitha dokumentet teknike dhe ato për funksionimin do të përgatiten të paktën 30 ditë para kohës së testeve.

4.5.4 Integrimi i Sistemit dhe Testimet (SI&T)

Shitësi do të kryejë Integrimin e Sistemit dhe Testimin në kantier në përputhje me planin e testeve dhe procedurat e testimit. Kjo do të bëhet në Kullën e vrojtimit të ACC/APP në Tiranë në përputhje me grafikun e Kontratës.

4.5.5 Procedurat për Testin e Pranimi në Terren

Pas instalimit dhe integritetit të çdo nënsistemi kryesor në vendin e punës, Shitësi do të kryejë testin e pranimi në vendin e punës (teren)(SAT) në përputhje me procedurat e miratuara për testim. Procedurat për testin e pranimi në vendin e punës do të paraqiten të paktën 30 ditë para datës së testimit të planifikuar.

Gjatë testit SAT, niveli i vendit të punës për verifikim do të kryhet në vendin e caktuar. Certifikata për instalimin e nënsistemeve dhe lista e kontrollit do të vënë në dukje të gjitha cilësitë në funksionimin e sistemit. Ai përfshin demonstrimin e një end-item, nënsistemin dhe aktivitetet e kryera për pranimin përfundimtar të sistemit.

Çdo procedurë SAT do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

Emri i testit.

Objektivi i testit.

Karakteristikat e verifikuara të specifikimeve teknike.

Metoda e verifikimit.

Lidhjet me testet e tjera.

Elementi i duhur i sistemit.

Pajisjet e testit dhe kushtet e veçanta që kërkojnë (d.m.th. simulator, regjistruar datash, etj.).

Pajisjet e jashtme, kushtet dhe shërbimet me komunikim të jashtëm, nëse ka, të evidentuara.

Një diagram që tregon ndërlidhjen e të gjitha elementeve në konfigurimin e testit.

Një procedurë hap-pas-hapi për përpunimin nëpërmjet testit.

Evidentimi i rezultateve që duhet të regjistrohen.

Rezultatet e pritshme në çdo hap.

4.5.6 Testet e Pranimi në Vendin e punës-teren (SAT)

Shitësi duhet të demonstrojë se nënsistemet plotësojnë kërkesat bazë të Blerësit, siç pasqyrohet prej tij në matësin e përputhjes së kërkesave dhe që është gati të livrohet për në vendin e punës.

Në Kullën e vrojtimit të ACC/APP në Tiranë testi SAT do të kryhet në përputhje me grafikun e Kontratës. Shitësi do të përgjigjet për çdo ndryshim që del gjatë testimit për marrjen në dorëzim krahasuar me nënsistemin që është livruar. Shitësi do të sigurojë personelin teknik të kualifikuar për zgjidhjen në

kohë të problemeve dhe korrigjimin e gabimeve gjatë etapave të plotësimit të testeve SAT. Dalja me sukses e testeve SAT në vendin e punës do të konsiderohet si pranim zyrtar prej Blerësit. Blerësi do të synojë që të arrijë kapacitetin e operimit dhe funksionimit 60 ditë pas pranimit në vendin e punës.

4.5.7 Raporti për Testin e Pranimit në vendin e punës – terren (SAT)

Raporti për testin SAT do të dorëzohet brenda 60 ditëve pas përfundimit të testimit. Ky Raport do të përmbledhë të gjitha rezultatet dhe gjetjet e testit të Shitësit dhe do t'i krahasojë ato me kërkesat e veçanta që u testuan. Raporti i testit do të shoqërohet me një pasqyrë të plotësuar me të dhënat për çdo test SAT të përfunduar.

Raporti do të përmbajë objektivat e testit, rezultatet e testit, përmbledhje analitike, konkluzionet, problemet e dala dhe rekomandimet. Rezultatet e cilësisë, sasisë dhe kufijtë e besueshmërisë do të përmbledhen dhe do të referohen te kërkesat e nevojshme të specifikimeve. Në raportin e testit minimalisht do të trajtohen çështjet e mëposhtme që kanë të bëjnë me elementet e sistemit që testohet:

Funksionimi i kushteve dhe i pajisjeve (facilitete).

Shkalla e veprimtarisë së pajisjeve dhe kushteve.

Cilësia.

Rezultatet e testimit.

4.6 Trajnimi

Për nënsistemet e livruara Shitësi do të sigurojë kurse trajnimi për një operim dhe mirëmbajtje normale të tyre, të cilat ofrohen bashkë me nënsistemet COTS. Shitësi do të paraqesë një detajim për trajnimin që ofrohet, ku përfshihet lloji i trajnimit, kohëzgjatja, vendi dhe numri i studentëve për çdo klasë. Shitësi do të sigurojë trajnimin për personelin e mirëmbajtjes për të mundur Blerësin të kryejë nivelin 1, nivelin 2 dhe nivelin 3 të mirëmbajtjes (mirëmbajtje mbrojtëse, përcaktimin e problemeve dhe instalimin/shkëmbimin e njësive që zëvendësohen në fushë).

Shitësi do të paraqesë Planin e Trajnimit brenda 90 ditëve pas nënshkrimit të Kontratës që do të përmbajë pikat kryesore për secilin kurs trajnimi dhe kërkesat e kushtet për kryerjen e trajnimit. Meqenëse disa nënsisteme kryesore do të porositen, livrohen dhe instalohen në vitin e tretë dhe të katërt të Kontratës, Plani i testeve do të jetë evolues dhe do të përfshijë trajnimet për nënsistemet që do të livrohen më vonë, në versione të tjera të Planit të testimit.

4.7 Garancia

Shitësi do të sigurojë një standard garancie prej 24 muajsh, i cili ofrohet me nënsistemet komerciale të gatshme COTS, nëse ka. Shitësi do të paraqesë një përshkrim për standardin e garancisë së furnizuesit. Shitësi do të specifikojë jetëgjatësinë e pritshme e të domosdoshme për çdo produkt dhe do të përshkruajë metodën që rekomandohet për të realizuar një funksionim të vazhdueshëm gjatë gjithë jetëgjatësisë së pritshme të sistemit.

4.8 Plan për përgatitjen e vendit të punës dhe aktivizimi

4.8.1 Asistenca për instalimet

Shitësi do të përgjigjet për të mbështetur instalimin në vendin e punës së nënsistemeve. Shitësi do të japë kërkesat për instalimin e nënsistemeve, ku do të përfshihen pa ndonjë kufizim kërkesat për vendin, hapësirën, aksesin për shërbimin, ftohjen, energjinë elektrike, kërkesat sizmike për montim, sistemimin e telave, kabllot dhe truallin. Shitësi do të sigurojë që këto kërkesa të jenë vendosur në mënyrë korrekte dhe Blerësi do të marrë masat që mjedisi të jetë përgatitur sa më mirë për instalimet. Kërkesat për mjedisin e vendit të punës do të përshkruhen në Planin për Instalimin e Sistemit. Shitësi do ta paraqesë këtë plan që të përdoret si “dizenjo zyrtare e mjedisit” të vendit të punës. Përgatitja e vendit të punës dhe punimet civile do të kryhen nga NATA, e cila merr përsipër përgatitjen e vendit të punës për të kryer instalimet.

4.8.2 Plani i instalimeve

Shitësi do të përgatisë dhe do të paraqesë Planin e instalimeve për nënsistemet e porositura brenda 90 ditëve pas nënshkrimit të Kontratës. Meqenëse disa nënsisteme do të porositen, livrohen dhe instalohen në vitin e tretë dhe të katërt të Kontratës, plani i instalimeve do të jetë evolues dhe livrimet e mëvonshme do të përbëjnë versione të tjera të Planit të instalimit. Vizatimet paraprake do të paraqiten pasi të përfundojnë punimet dhe rregullimet dhe të vihen ato në shfrytëzim. Dorëzimi përfundimtar i Paketës

komplete të vizatimeve të ndërtimit do të realizohet 90 ditë pas Testit të Pranimit në Terren të nënsistemit.

4.9 Ruajtja, paketimi, ambalazhimi dhe marketimi

Të gjitha grupet elektronike do të ruhen, ambalazhohen dhe paketohen në përputhje me praktikat më të mira tregtare dhe, si përcaktohet këtu, me qëllim që të mbrohen nga dëmtimet fizike e mekanike dhe të lehtësohet puna për lëvizjen e tyre me mjete të mekanizuara.

Pajisjet elektronike të montuara brenda kabineteve do të sigurohen me materiale të buta për të evituar ndonjë lëvizje ose dëmtim të pajisjeve gjatë transportit. Një material i tillë çambalazhohet me lehtësi në vendin që do të instalohet.

Në pjesën e përparme të çdo kabineti ose në pjesën e brendshme të derës ballore do të vendoset një letër me instruksionet e nevojshme, ku do të evidentohet se cili material duhet të hiqet gjatë instalimit. Mënyra për mbrojtjen e brendshme të pajisjeve dhe letra me instruksionin do të miratohen nga LMATM para livrimit të dërgesës së parë te LMATM.

Zgarat do të sigurohen duke u montuar në mbështetëse druri (e livruar bashkë me zgarat) dhe do të futen në kontenier me karton të valëzuar me mbrojtje në krah dhe pjesën e sipërme sipas Feb.Spec. PPP-B-640 ose sipas një ambalazhi komercial ekuivalent. Pas mbështetjes prej druri dhe para futjes në kontenier, çdo zgarë do të mbulohet me material të butë celolose sipas normave Feb. Spec. PPP-C-834 ose ekuivalentit komercial, e siguruar edhe me shirita 2 inch të gjerë të ndjeshëm ndaj presioneve të ndryshme. Pastaj kjo do të mbulohet me fletë polietileni, të lidhura fort dhe të siguruara me shirita.

Çdo kontenieri do t'i vihet një etiketë identifikimi në panelën ballore si edhe adresa në bazë të instruksioneve të hollësishme që do të japë LMATM. Etiketa e identifikimit do të jetë e sheshtë, me ngjyrë të bardhë, e fiksuar në këndin e sipërm, krahu i majtë i pjesës ballore të panelit. Përmbajtja e etiketës së transportit do të jepet nga LMATM dhe do të fiksohet në pjesën e sipërme, në qendër të panelës ballore.

4.10 Mirëmbajtja dhe asistenca për logjistikën e integruar

4.10.1 Ndhurma për mirëmbajtjen

Shitësi do të paraqesë mënyrat me kosto nga më efektivet për të siguruar asistencën për mirëmbajtjen e sistemit që ofrohet për gjatë gjithë jetës së tij të pritshme në punë. Koncepti që propozohet duhet të përfshijë shërbimet për riparimin e pjesëve ose shërbimet për zëvendësimin e tyre. Shitësi do të bëjë një vlerësim për fuqinë punëtore që duhet për të mbështetur funksionimin e sistemeve.

Propozimi do të përmbajë të gjitha hollësitë për koston e riparimeve dhe kohën e duhur, si edhe një tregues për burimet financiare të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e shërbimeve që do të ofrohen në fabrikë dhe në vendin e punës. Shitësi do të rekomandojë nivelin e shërbimeve në vendin e punës dhe do të mbajë në depo pjesët e duhura për të mirëmbajtur sistemin për gjatë gjithë jetës së pritshme në punë.

Shitësi do të përgatisë pikat kryesore të strategjisë për mbështetjen e produktit për të siguruar jetëgjatësinë e pritshme në punë të sistemit.

4.10.2 Koncepti i mirëmbajtjes

Koncepti i mirëmbajtjes për pajisjet/sistemin që do të ngrihet sipas këtij Projekti përfshin sa më poshtë:

Pajisjet dhe sistemet, duke përfshirë pajisje automatike për testimet (BITE).

Të zbulohen dhe izolohen defektet në grupet e zëvendësueshme të linjës (LRU).

Defektet në pajisjet dhe sistemin do të korrigjohen në vend, duke zëvendësuar LRU-në që del se është dëmtuar.

LRU-ja e dëmtuar do të riparohet nga Shitësi falas deri në përfundimin e periudhës së garancisë.

Duhet të sigurohet një gjendje në depo me kosto efektive, e cila do të shfrytëzohet për raste urgjente dhe të riparohen LRU në nivelin e defekteve për pjesë të veçanta.

4.10.3 Ndhurma të tjera

Nëpërmjet Testit të Pranimit në Fabrikë, Shitësi do të sigurojë mbështetje për aktivitete të tilla, por jo të kufizuara te këto, si më poshtë:

Diskutime për arkitekturën dhe mbledhjet teknike.

Përdorimi i interfa për shërbimet e përshtatjet (Customization).

Program mbledhjesh/shqyrtimesh.

Integrimi i sistemit.

Për të gjitha produktet Shitësi do të ndihmojë në instalimin, përshtatjen dhe shërbimet e kontrollit ku përfshihen:

Instalimi i zgarave, i procesorëve, i kablllove, i paneleve në konsolle etj.

Përshtatja (Customization) për një vend të veçantë pune.

4.10.4 Pajisjet për teste të veçanta

Shitësi duhet t'i minimizojë nevojat për teste të veçanta për pajisjet. Kur kjo nuk është e mundur, Shitësi do të sigurojë pajisjet për testimet speciale të nevojshme për diagnostikimin e sistemeve, të cilat nuk mund të bëhen duke përdorur pajisjet e testimit për “përdorim të zakonshëm” që disponohen në tregun e shitjes.

4.10.5 Materialet për instalimin

Shitësi do të japë të gjithë artikujt që duhen për instalimin e pajisjeve. Shitësi përgjigjet për sigurimin e konduktorëve me rezistencë të ulët për të lidhur të gjitha njësitë e sistemeve me planin e lidhur në tokë. Plani i sistemit me lidhje në tokë do të funksionojë si një i tërë.

4.10.6 Vegla pune

Shitësi do të sigurojë çdo vegël pune për testimin, indikatorë dhe/ose simulatorë të nevojshëm për të verifikuar nevojat kryesore të Blerësit.

4.11 Matësi për përshtatjen e kërkesave

Shitësi do të sigurojë një model për përshtatjen e kërkesave, në bazë të një formati që sqarohet me poshtë. Ky model do të përdoret për të vlerësuar aftësitë e nënsistemeve kundrejt kërkesave të Projektit shqiptar.

Kopjet elektronike të dokumenteve shoqëruese të këtij Raporti Pune do t'u dërgohen furnizuesve sipas kërkesës. Shitësi do të sigurojë një model krahasimi për plotësimin sa më poshtë të secilit “shall” që përmban çdo dokument për kërkesën. Shitësi mund të zgjedhë njërin nga:

1) Printon një kopje të dokumentit të kërkesës dhe nënvizon dokumentin, siç shprehet më poshtë, ose

2) Vendos modelin në kopjen elektronike, duke futur në dokument informacionin e përshkruar më poshtë.

Shitësi mund të përzgjedhë një nga metodat për të dhënë informacionin për përshtatjen.

Nëse një aftësi aktuale e nënsistemit e plotëson një kërkesë, atëherë “përputhje e plotë” do të shënohet te titulli i kërkesës përkatëse.

Nëse një aftësi aktuale e nënsistemit ka kufizime në lidhje me një kërkesë të veçantë, “përputhje e pjesshme” duhet të shtohet te titulli i kërkesës përkatëse. Kufizimi i veçantë duhet të përshkruhet duke dhënë çdo alternativë ose të dhënat e planifikuara që përputhen plotësisht. Kufizimi mund të vendoset në kopjen elektronike menjëherë pas linjës së titullit OR nëse një version i printuar, i shënuar me të kuqe, është dhënë si përputhje e përgjigjes së Shitësit, dhe mund të jepet një fletë bashkëlidhur duke evidentuar numrin e referencës së kërkesës dhe të kufizimit.

Nëse në aftësitë aktuale të nënsistemit që propozohet nuk plotësohet një kërkesë, “mospërputhje” do të shënohet te titulli i kërkesës përkatëse. Nëse aftësia është aktualisht në zhvillim e sipër ose është përfshirë në Planin e Produktit, datat e planifikuara për disponueshmërinë e funksionimit të përcaktuar duhet të jepen në të njëjtën mënyrë si përgjigjja për “përputhjen e pjesshme” e përmendur më sipër.

4.12 Sigurimi i produktit

Gjatë realizimit të Kontratës, Shitësi do t'u përmbahet të gjitha rregullave që aplikohen në SHBA dhe në rajonet lokale për sigurimin e produkteve.

4.13 Prodhimi

4.13.1 Menaxhimi i prodhimit

Shitësi është përgjegjës për prodhimin.

4.13.2 Planifikimi i prodhimit

Shitësi do të planifikojë prodhimin e sistemit dhe të nënsistemeve. Ai do të planifikojë metodat

dhe konceptet për të shfrytëzuar materialet e shitësit, mjetet e punës dhe burimet për fuqi punëtore.

Shitësi do të planifikojë të gjitha aktivitetet e prodhimit, të ndara në periudha kohore, që duhen për të blerë, për të prodhuar, për të kontrolluar dhe për të livruar artikujt e pranueshëm sipas Kontratës.

4.13.3 Prodhimi hardware

Shitësi do të blejë, do të prodhojë, do të kontrollojë dhe do të livrojë pajisjet për misionin e sistemit, siç specifikohen këtu.

4.13.4 Përgatitja e raportimeve

Shitësi do të dorëzojë në PMR çdo muaj gjendjen e grafikut dhe ecurinë e prodhimit. Ky raportim duhet të evidentojë, por nuk duhet të kufizohet vetëm këtu, realizimet, gjendjen e zërave afatgjatë, prodhimin, montimin dhe testimin. Shitësi do të evidentojë zonat me problemet aktuale dhe ato që mund të dalin dhe planin e masat për korrigjimin e tyre. Raportimi duhet, të përmbajë gjithashtu aktivitetet nënkontraktuese që lidhen ose mbështesin direkt Projektin.

5. Skema e Projektit

Skema e Projektit përmban etapat më të rëndësishme të Programit shqiptar që do të mbështesë Shitësin. Grafiku i Kontratës duhet të azhurnohet me gjëra të reja dhe të paraqitet në PMR.

6. Menaxhimi i Programit

Lidhjet e Projektit të Qeverisë Shqiptare për Modernizimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare vihen në dukje më sipër.

Në realizimin e kësaj Kontrate Shitësi duhet të jetë në përputhje me sa më poshtë:

Të sigurojë menaxhimin e nevojshëm, prodhimin, anën teknike, mjetet e kushtet, materialet dhe shërbimet që të përputhen plotësisht me kërkesat e këtij Raporti Pune.

Të sigurojë një staf në nivelin e duhur dhe të përshtatshëm për prodhimin, për menaxhimin e konfiguracionit, për menaxhimin e problemeve, për kontrollin e cilësisë, për integrimin, për mbështetjen për instalimin, për testimet, për mirëmbajtjen, për asistencën në kantier dhe trajnimin.

Të planifikojë, administrojë dhe kontrollojë dokumentacionin financiar, teknik dhe atë shoqëruar.

Të planifikojë, të menaxhojë dhe të mbështesë kërkesat e të gjithë programit gjatë gjithë periudhës së realizimit të Kontratës.

Të zbatojë procedurat për menaxhimin me efektivitet të të dhënave dhe të informacionit.

Të dhënat e livruara si rezultat i realizimit të kërkesave të specifikuara në këtë Raport Pune do të përgatiten, do të plotësohen dhedho të rifreskohen në përputhje me paragrafin 8.2.

6.1 Menaxheri i Programit

Shitësi do të caktojë një menaxher të Programit që të organizojë, të planifikojë, të bëjë grafikun, të implementojë, të kontrollojë, të analizojë dhe të raportojë për të gjitha elementet e Kontratës. Menaxheri i programit do të ketë burimet financiare dhe autoritetin e nevojshëm për të siguruar një realizim me efektivitet, eficiencë dhe në kohë të Programit dhe do të jetë një pikë referimi në institucionin e Shitësit për të gjitha detyrat që kërkon Programi.

6.2 Shqyrtimet

Këto shqyrtime do të kryhen gjatë periudhës së realizimit. Shitësi mund të planifikojë shqyrtime të tjera nëse del e nevojshme nga Programi.

6.2.1 Shqyrtimi i menaxhimit të Programit (PMR)

Shitësi do të kryejë shqyrtime për menaxhimin e Programit siç është paraqitur në grafikun e Kontratës dhe në afate kohore si do ta kërkojë puna. Blerësi dhe Shitësi do të vendosin për vendin para çdo shqyrtimi (PMR). Shqyrtimet do të drejtohen nga menaxheri i programeve të Shitësit.

6.2.2 Mbledhjet teknike të përbashkëta (TIM)

Shitësi do të mbështesë organizimin e mbledhjeve teknike të kombinuara me Blerësin, furnizuesin ose pjesëmarrës të tjerë në Projekt sipas kërkesave. Mbledhjet mund të organizohen me korrespondencë ose personalisht, në intervale të caktuara, siç do ta kërkojë Programi gjatë gjithë periudhës së realizimit. Kryeinxhinieri do të përgatisë një plan pune për mbledhjet, i cili do të përfshihet në grafikun e Kontratës. Kryeinxhinieri i LMATM-së, që është kontakti kryesor për çështjet teknike, do të drejtojë mbledhjet.

Qëllimi i këtyre mbledhjeve do të jetë që të përpunohen specifikimet bashkërisht për t'u siguruar që të gjitha çështjet teknike janë zgjidhur në kohën e duhur. Ato mund të shqyrtojnë kërkesat e hollësishme të sistemit dhe arkitekturës, interfeisin e sistemit, çështjet që kanë të bëjnë me instalimin, testimet, mbivendosjet e nivelit të kërkesave të sistemit për të funksionuar e siguruar qëndrueshmërinë dhe disponueshmërinë, si edhe përcaktimin e adaptimeve.

6.3 Raportimet

6.3.1 Raportimet për gjendjen

Shitësi do të përgatisë raporte mujore me shkrim për gjendjen. Këto raporte i dorëzohen Blerësit. Qëllimi i këtyre raporteve është që Shitësi të hyjë në brendësi të planifikimit të Programit dhe në të gjitha metodat e menaxhimit. Të gjitha veprimet e hapura gjatë muajit do të regjistrohen dhe do të ndiqen deri në zgjidhje. Minimalisht, raporti duhet të përmbajë këto të dhëna:

- Realizimet e muajit të kaluar.

- Realizimet e planifikuara me afate të shkurtra.

Raporti i Punës (SoW), gjendja teknike, financiare dhe grafiku i Kontratës, duke përfshirë fushat e zgjidhjeve të problemeve të ndryshme, si edhe ndryshimet e njohura ose që parashikohen ndërmjet SoW të planifikuar dhe realizimit faktik, çështjeve teknike, grafikut dhe aktiviteteve financiare.

Realizimi i grafikut, duke përfshirë evidentimin e pengesave kryesore që qëndrojnë pas varianteve të ndryshme dhe planin e masave për zgjidhjen e këtyre varianteve.

- Grafiku i rrugëve të vështira.

- Përcaktimi dhe implementimi i mundësive të ndryshme rreth planeve të punës.

- Mundësitë dhe risqet e Programit dhe planet për uljen e rreziqeve dhe shfrytëzimin e mundësive.

Gjendja e prodhimit, duke përfshirë gjendjen kundrejt grafikut, evidentimi i veprimtarive të rëndësishme, gjendja e montimeve kryesore dhe mungesat e pjesëve të rëndësishme.

Gjendja e testeve, duke përfshirë gjendjen e raporteve të hapura teknike të programit dhe diferencat hardware. Raportet që përmbajnë planet e nevojshme.

- Gjendja për mbështetjen e logjistikës së integruar.

- Çështjet e ndryshme dhe planet e veprimeve për korrigjimet e mundshme.

Gjendja e të gjitha veprimeve të veçanta, livrimet CDRL, propozimet për ndryshimet inxhinierike.

Gjendja e cilësisë, veprimet e hapura dhe gjendja pas veprimeve të veçanta dhe kontrollet e cilësisë deri sot.

Të gjitha raportet do t'i jepen Blerësit sipas formatit të Shitësit.

6.3.2 Veprimet e veçanta

Shitësi do të mbajë një listë për veprimet e veçanta, ku do të përfshihen çështjet e Kontratës, e grafikut dhe çështjet financiare. Lista do të koordinohet rregullisht me Blerësin. Një kopje e veprimeve të veçanta do të shoqërojë raportet mujore.

6.4 Plani për menaxhimin e Projektit

Shitësi do të paraqesë Planin për menaxhimin e Projektit 90 ditë pas nënshkrimit të Kontratës, duke përfshirë sa më poshtë:

- Një grafik pune për kryerjen e veprimtarive kryesore, livrimet dhe afatet.

- Pasqyrimi i përpjekjeve të Shitësit.

Njerëzit kryesorë të cilët do të angazhohen për menaxhimin e Projektit, nivelin e tyre teknik, me Projektin dhe përgjegjësitë e tyre.

- Planet e konfiguracionit.

- Planet e testimeve.

Do të hartohet një përmbledhje për radhën e punës që të jetë sipas kërkesave të Raportit të Punës (SoW).

- Rreziqet dhe mundësitë kryesore dhe si do të menaxhohen ato.

- Datat e nevojshme të planifikuara për furnizimin e Blerësit me artikuj.

- Kërkesat për përputhjen e matësit (matrix) me Raportin e Punës (SoW).

6.5 Modifikimet

Shitësi do të njoftojë Blerësin për ndryshimet në formë, në përshtatje dhe funksionim në lidhje me disenjimin e artikujve, të njërive dhe të nënsistemeve të hartuara pasi janë livruar pajisjet. Nëse nuk bihet dakord ndryshe ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, do të kuptohet se çdo pjesë ndërrimi e furnizuar ose çdo njësi e riparuar nga Shitësi do të konsiderohet se ka arritur standardin e pajisjeve, siç ka qenë kur u livrua fillimisht sipas Kontratës. Shitësi do të raportojë për çdo situatë “vdekje” (fund i jetës) që mund të ndodhë gjatë periudhës së realizimit.

6.6 Menaxhimi i interface (mënyra e komandimit të programeve)

Shitësi do të vlerësojë dhe do të sigurojë për Blerësin inputet për interface-in e brendshëm të sistemit. Shitësi do të dokumentojë çdo propozim për ndryshimin e interface-it ose do ta azhurnojë atë sipas analizave dhe studimeve. Shitësi do të ndihmojë Blerësin për zgjidhjen e çështjeve të interface-it që mund të dalin.

6.7 Menaxhimi i ndryshimeve

Shitësi do të mbajë linjat bazë të Kontratës. Nëse Blerësi kërkon ose gjen punë që duhet kryer jashtë objektivit bazë të Kontratës, atëherë Shitësi do të paraqesë propozimin për ndryshim, duke dokumentuar ndryshimin e objektit të punës, ndryshimin e afateve dhe ndryshimin e çmimeve që lidhen me ndryshimin e linjave bazë të Kontratës. Kur është e mundur, Blerësi dhe Shitësi do të përgatisin urdhrin për ndryshime, i cili do të negociohet në lidhje me objektivin, afatet dhe çmimet para se të fillojë puna. Kur një ndryshim është urgjent, Blerësi dhe Shitësi mund të bien dakord të fillojnë nga puna në bazë të një autorizimi me shkrim të pranuar bashkërisht dhe ndërkohë përgatitet propozimi për ndryshim. Kur është e nevojshme, Blerësi dhe Shitësi mund të bien dakord për të përgatitur dhe diskutuar propozimet për ndryshimet e ndodhura më parë, që të dokumentohen ndryshimet dhe të ripunohet baza e Kontratës.

Përgatitja e urdhrin të ndryshimeve është një objekt pune shtesë dhe propozimi për urdhrin e ndryshimeve do të përfshijë objektin, afatin dhe koston e përgatitjes së urdhrin të ndryshimeve.

6.8 Përzgjedhja e furnizuesit

Shitësi do të koordinojë me Blerësin për përzgjedhjen e furnizuesit. Për furnizuesit shqiptarë Blerësi duhet të ketë autorizim përkatës të miratuar.

7. Administrimi

7.1 Komunikimi

7.1.1 Komunikimi ndërmjet Shitësit dhe Blerësit

Të gjitha komunikimet zyrtare ndërmjet Shitësit dhe Blerësit do të bëhen nga persona me funksione të caktuara. Shitësi do të caktojë një pikë të vetme kontakti zyrtar për të gjitha komunikimet e mundshme. Pika e kontaktit e Shitësit për Blerësin do të jetë Administratori i Kontratës, i cili do të trajtojë të gjitha çështjet teknike, tregtare dhe programatike. Ky Administrator përgjigjet të mbajë shënime për të gjitha komunikimet, t'i referojë ato te personat e tjerë përgjegjës dhe t'i ndjekë ato deri në fund.

Nga ana tjetër, është gjithashtu i nevojshëm një komunikim zyrtar, në një nivel të caktuar, ndërmjet njerëzve të Shitësit dhe të Blerësit. Megjithatë drejtuesit kryesorë do të marrin pjesë në Raportet për Menaxhimin e Projektit (PMR) dhe Mbledhjet Teknike të Përbashkëta (TIM), do të mbështeten aktivisht në bisedat jozyrtare të vazhdueshme në lidhje me problemet e punës.

7.1.2 Korrespondenca

Korrespondenca do t'i adresohet personit përkatës në adresën e mëposhtme:

Nigel Shreeve

Administratori i Kontratës, Lockheed Martin Air Traffic Management

New EnRoute Center

Sopwith Way, Southampton Hampshire, SO31 7AY

United Kingdom

7.1.3. Blerësi

Blerësi do të japë hollësira gjatë nënshkrimit të Kontratës për Administratorin e tij të Kontratës.

7.2 Informacionet për ngarkimin e mallrave

Dërgesat e mallrave të LMATM në Rockville, përveç korrespondencës, do t'i adresohen personit

përgjegjës në adresën e mëposhtme. Përveç kësaj, emri i Programit, numri i Kontratës dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm do të shënohen në dokumentet e ngarkimit. Adresa e destinacionit në ACC do të jepet më vonë. LMATM do të respektojë të gjitha rregullat për kontrollin e eksporteve në SHBA kur do të eksportoje ndonjë mall për Blerësin.

7.2.1 Menaxhimi i Trafikut Ajror Lockheed Martin (LMATM)

Lockheed Martin Air Traffic Management

Material Distribution Center

1900 Woodfield Road

Gaithersburg, Maryland 20879, USA

Tel. 305-519-3880

Fax. 301-258-0735

Pikë kontakti: Lawrence Israel

e-mail: lawrence.israel@Imco.com.

7.2.2 Blerësi

Përveç korrespondencës, Blerësi do të japë adresën për dërgimin e mallit.

7.3 Kontrolli i eksportit

Gjatë realizimit të Kontratës Shitësi do të respektojë rregullat për kontrollin e eksporteve në SHBA dhe në shtetet përkatëse, si edhe rregullat e tjera ndërkombëtare. Shitësi do të mbajë kontakte të rregullta me Koordinatorin e kontrollit të eksporteve në LMATM për të gjitha dërgesat e eksportit dhe do të sigurojë të gjitha dokumentet e nevojshme për kontrollin doganor në SHBA. Shitësi do të sigurojë të gjithë dokumentacionin për transportin në SHBA dhe dokumentacionin për dërgimin në destinacion tek ACC.

Shitësi do të japë gjithashtu një pikë kontakti për të gjitha çështjet e eksportit dhe për të koordinuar të gjitha dërgesat.

Pika e kontaktit për çështjet e eksportit me LMATM është:

Ron Payne

Office & Voice Mail: (301)640-3830

Fax.Tel. (301) 640-4548

E-mail: ron.payne@Imco.com.

Adresa postare:

Air Traffic Management

869/4B10

9221 Corporate Blvd

Rockville, MD 20850

8. Grafiku i Livrimeve

Shitësi do të paraqesë artikujt që do të livrohen sipas Kontratës siç përmbliken më poshtë. Nëse nuk shprehet ndryshe në këtë Raport Pune, specifikimet e zërave do të përgatiten në formatin e Shitësit.

8.1. Livrimet materiale sipas numrit të artikullit në Kontratë

Më poshtë specifikohen produktet dhe shërbimet kryesore për t'u livruar dhe caktohet një identifikues alfanumerik i veçantë CLIN me qëllim të evidentojë nënsistemet dhe artikujt për planifikim, menaxhim dhe caktimin e çmimeve. Të dhëna të tjera të hollësishme jepen në shtesën 1 të këtij dokumenti si: Zbërthimi i objektivave dhe lista me objektet e punës, pasqyra e çmimeve të Kontratës që përmban të gjitha livrimet kryesore sipas numrit të zërit në Kontratë, emërtimi i tyre dhe çmimi për secilin. Livrimet cilësohen si të tilla gjatë Fazës 1 dhe Fazës 2.

8.1.1 CLIN F102 Ndhmon Blerësin për sigurimin e financimit tregtar

Shitësi do të ndihmojë Blerësin për të siguruar financimin tregtar. Shërbimi do të përfshijë organizimin dhe drejtimin e tenderit për borxhdhënësin tregtar, asistencë nga Agjencia për Kreditimin e Eksportit në lidhje me aplikimin, asistencë në veprimet e duhura e që kërkojnë kujdes dhe asistencë për përgatitjen e drafteve për negociatat dhe marrëveshjet. Shitësi do t'i kryejë këto shërbime gjatë Fazës së parë.

8.1.2 CLIN SU03 Livrimi dhe instalimi i një Automati të ri për menaxhimin e trafikut ajror.

Sistemi

Shitësi do të hartojë, prokurojë, integrojë, livrojë, instalojë, testojë dhe do t'i dorëzojë Blerësit një Sistem automatizimi të ri dhe modern për Menaxhimin e trafikut ajror, i cili ndërrohet me standardet dhe dispozitat e ICAO-s dhe Eurokontrollit për t'u përmirësuar vazhdimisht dhe të jetë ndërrohet edhe me standardet që do të kërkohen në të ardhmen. Livrimet e para do të instalohen në ndërtesën ekzistuese të ACC/APP dhe do të realizojnë automatizimin për të siguruar fillimisht kushtet për një kontroll me radarë, për të rritur kapacitetet e hapësirës ajrore për të përballuar rritjen e trafikut që pritet të ndodhë gjatë Lojërave Olimpikë në verën e vitit 2004. Livrimet e dyta do të instalohen në Kullën e re të ACC/APP dhe do të sigurojnë automatizimin për një modernizim të plotë të sistemeve të radarëve të CNS/ATM-së. Ky CLIN përmban gjithashtu SUR01. Për kompletimin e livrimit Shitësi do të organizojë me sukses testimet e pranimit që janë rënë dakord. Shitësi do të paraqesë pasqyrën e kërkesave dhe faturën e Materialeve gjatë Fazës së parë. Të gjitha livrimet që mbeten Shitësi do t'i livrojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.3. CLIN BL10 Modifikimi dhe rregullimi i ndërtesës ekzistuese për radarin e parë

Aftësia

Shitësi do të përgatisë dhe do të dokumentojë planin për modifikimin dhe rregullimin e ndërtesës ekzistuese të ACC/APP për të pritur livrimet e para ATM për sistemin e automatizimit të CLIN SU03. Shitësi do të prokurojë punën për modifikimin dhe rregullimin e ndërtesës në përputhje me planin e miratuar. Shitësi, gjithashtu, do të kryejë testimin e rënë dakord për marrjen në dorëzim dhe përfundimin e livrimeve. Këto shërbime Shitësi do t'i kryejë gjatë Fazës së parë.

8.1.4 CLIN BL07 Livrimi i një Kulle të re për ACC/APP

Shitësi do të përgatisë dhe do të dokumentojë një plan për ndërtimin e një godine të re ku do të vendoset Kulla e ACC/APP dhe ku do të operojnë funksione e njerëz të tjerë që do të bihet dakord. Pas miratimit të Blerësit, Shitësi do ta prokurojë këtë shërbim, me qëllim që të përcaktojë kërkesat, të kryejë studimin e vendit dhe të mjedisit përreth dhe të përgatisë një ide ndërtimi të përshtatshme për realizimin e projektidesë (disenjimin) së ndërtesës dhe tenderimin e ndërtimit. Shitësi do të prokurojë shërbimet për disenjimin, ndërtimin, testimin dhe dorëzimin e ndërtesës të Blerësit për instalimin e pajisjeve. Shitësi do të kryejë me sukses testimin e rënë dakord të pranimit për të përfunduar livrimin. Shitësi do të paraqesë idenë e ndërtimit dhe shërbimet e tjera ndihmëse gjatë Fazës së parë. Gjatë Fazës së dytë Shitësi do të livrojë të gjitha mallrat e tjera.

8.1.5 CLIN FI10 Dhënia e asistencës për menaxhimin financiar

Shitësi do t'i japë Blerësit shërbime konsultative për menaxhimin financiar për të përmirësuar sistemin e kontabilitetit, me qëllim që të evidentojë më saktë, të shpërndajë dhe të ndjekë sa më mirë shpenzimet. Shitësi do të ndihmojë Blerësin për përgatitjen, për paraqitjen dhe për justifikimin në bazë të kostos për të përballuar shpenzimet e lëvizjeve ajrore që llogariten gjatë viteve 2002, 2004 dhe 2005. Kjo CLIN përmban gjithashtu edhe LAW01. Shitësi do t'i kryejë këto shërbime gjatë Fazës së parë dhe Fazës së dytë në përpjestim me vleftat e CLIN.

8.1.6 CLIN OR05 Dhënia e ndihmës dhe shërbimeve për menaxhimin e Projektit

Shitësi do të sigurojë një zyrë për menaxhimin e Projektit për të planifikuar, organizuar, drejtuar dhe kontrolluar projektin. Shitësi do të sigurojë ekspertizën e nevojshme në lidhje me Operimin e Trafikut Ajror, punët inxhinierike, ato teknike, punimet civile, prokurimet, logjistikën, financën dhe menaxhimin për garantimin e cilësisë. Ky CLIN përfshin, gjithashtu, detyrat BL06, FIN03 dhe OTH03. Shitësi do t'i sigurojë këto shërbime gjatë Fazës së parë dhe Fazës së dytë në përpjestim me vleftën CLIN.

8.1.7 CLIN AT10 Operacionet e Trafikut Ajror dhe detyrat e tjera që lidhen me këtë

Shitësi do të plotësojë detyra të ndryshme në lidhje me Operacionet e Trafikut Ajror, financën, burimet njerëzore, legjislacionin, detyra organizative dhe të sigurimit, siç përshkruhen në Shtojcën 1 dhe konkretisht: AIS01, AIS02, AIS03, AIS04, AIS05, AIS08, ASM01, ASM03, ASM04, ASM09, ASM011, HUM02, LAW03, LAW04, LAW05, LAW06, NAV02, NAV05, NAV06, ORG01, ORG02, ORG03, ORG04, ORG06, SAF04SAF05, SUR05 dhe SUR08. Shitësi do t'i kryejë këto shërbime gjatë Fazës së parë dhe Fazës së dytë në përputhje me grafikonin e Projektit.

8.1.8 CLIN CO03 VCS të reja

Shitësi do të prokurojë, integrojë, dhe instalojë VCS të re me HMI të avancuar dhe një funksion të përparuar që do të ndëroperojë me standardet e ICAO dhe Eurokontrollit. Shitësi, gjithashtu, do të kryejë testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimin. Shitësi do t'i realizojë këto shërbime dhe livrime gjatë Fazës së dytë.

8.1.9 CLIN CO02 Pajisjet e radios në largësi

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë instalimin e radios rele në distancë VHF/UHF, që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Pajisjet, maksimumi, do të përbëhen nga 6 frekuenca dhe 12 transceivers. Shitësi do të kryejë testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimin. Këto livrime e shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

CLIN CO05 Transceiver VHF/UHF

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e transceiver VHF/UHF në Kullën e re të AC/APP, që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Pajisjet do të kenë maksimumi 9 frekuenca dhe 18 transceivers. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.11 CLIN CO07 VHF SATCOM

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e një (1) VHF SATCOM në Kullën e re të ACC/APP, që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.12 CLIN NA03 EnRoute DVOR

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e një (1) EbRoute DVOR në afërsi të Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.13 CLIN NA04 Një terminal DVOR dhe një ILS për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza"

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e 1 (një) Terminali DVOR dhe 1 (një) Cat 1 ILS në Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza" që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.14 CLIN SU02 Radari për survejimin fillestar të Terminalit

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e një radari për survejimin fillestar të terminalit që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.15 CLIN OT01 Pajisjet për Kullën e re

Shitësi do të prokurojë dhe do të ndihmojë në instalimin e pajisjeve në Kullën e re, që do të ndëroperojë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të përgatisë një plan për prokurimet dhe instalimet në përpjestim me vleftën e CLIN. Shitësi dhe Blerësi do të miratojnë planin para fillimit të blerjeve dhe instalimeve. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

CLIN OT02 Përmirësimi i pajisjeve meteorologjike

Shitësi do të përmirësojë pajisjet meteorologjike nëpërmjet prokurimit dhe ndihmës në instalimin e pajisjeve që do të ndëroperojnë me standardet e ICAO-s dhe Eurokontrollit. Shitësi do të përgatisë një plan për prokurimet dhe për instalimet në përpjestim me vleftën e CLIN. Shitësi dhe Blerësi do të miratojnë planin para fillimit të blerjeve dhe të instalimeve. Shitësi do të kryejë me sukses testimet e rëna dakord të pranimi për të përfunduar livrimet. Këto livrime dhe shërbime Shitësi do t'i sigurojë gjatë Fazës së dytë.

8.1.17 CLIN OR07 Zyra shqiptare për menaxhimin e projektit (PMO)

Shitësi do të marrë, do të plotësojë me stafin e duhur dhe do të trajnojë një Zyrë Shqiptare të

Shitësit për Menaxhimin e Projektit me personel banues në Shqipëri. Shitësi do të sjellë teknikën, njohuritë dhe aftësitë e duhura për anëtarët e PMO-së shqiptare, të cilët do të duhet për anëtarët e kësaj zyre në Shqipëri, që të kryejnë si duhet detyrat e tyre. Shitësi do t'i livrojë këto mallra e shërbime gjatë Fazës së dytë.

8.2. Të dhënat për artikujt që do të livrohen

Nr	Emërtimi	Nr. i kopjeve	Kërkesat për livrimin	Paragrafi në SoW
001	Plani për menaxhimin e Projektit	1	90 ditë pas kontratës	6.4
002	Plani i mbledhjeve për shqyrtim	1	5 ditë para mbledhjes	6.2.1
003	Paraqitja e PMR-së	1	5 ditë para PMR-së	6.2.2
004	Raporti mujor progresiv	1	10 ditë pas përfundimit	
005	Plani i testimit	1	90 ditë pas kontratës	4.5.2
007	Procedurat për Testet e Pranimit në Fabrikë	1	30 ditë para testimit	4.5.3
008	Procedurat për Testimet në Vendin e punës	1	30 ditë para testit	4.5.5
009	Raporti për testin e pranimit në vend	1	60 ditë pas testit	4.5.7
010	Plani i instalimit	1	30 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.8.2
011	Paketa e vizatimeve të ndërtimit	1	90 ditë pas instalimit	4.8.2
012	Paketa finale e vizatimeve të ndërtimit	1	90 ditë pas SAL-it	4.8.2
013	Plani i trajnimit	1	90 ditë pas kontratës	4.6
014	Manuali teknik dhe dokumentacioni	2	me pajisjet	4.2.2.1
015	Matësi për Përputhjen e kërkesave	1	90 ditë pas hyrjes në fuqi të kontratës	4.11
017	Procesverbalet të PMR-së dhe TIM-it	1	10 ditë pas përfundimit	6.2.2
018	Veprimet e veçanta	1	me datën e zërave 17	6.3.2
019	Materialet e trajnimit TBD		30 ditë para kursit	4.2.2.2
020	Mbështetja për logjistikën e integruar	1	90 ditë pas Fazës së dytë	

Shënim:

Blerësit i lihen deri 21 ditë pas paraqitjes së të dhënave për zërat për të bërë vërejtjet e tij, të cilat pas kësaj date konsiderohen të miratuara.

PLANI I PUNËS (SOW) I DETAJUAR PËR PROJEKTIN PËR MODERNIZIMIN E HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE (NAMP) TË SHQIPËRISË (TABELAT)

KUSHTET DHE AFATET E KONTRATËS SË PROJEKTIT PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE (NAMP)

ANEKSI 3

Plani i Pagesave me Faza

Versioni V2.0

Numri i Referencës: ALBGEN-0025

22 nëntor 2002

Grafiku i Pagesave për Fazën e parë të Projektit për Menaxhimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (NAMP) në Shqipëri

Faza e parë – Përshkrimi i etapave

Çmimi

Vlefë totale e Fazës së parë

3.295.000 USD

1. Nënshkrimi i Kontratës. Shitësi i dërgon faturën Blerësit pas nënshkrimit të Kontratës. 329.500 USD (10% e vlefës, Faza e parë)

2. Shitësi i dërgon Blerësit Ofertën tregtare bankare. 988.500 USD (30% e vlefës, Faza e parë)

Paraqet letrën e livrimit për konfirmim. Dy muaj pas hyrjes në fuqi të 2804

Kontratës.

3. Shitësi i dërgon Blerësit kërkesat për ndërtesën e re.

823.750 USD (25% e vleftës Faza e parë)

Paraqet letrën e livrimit për konfirmim. Pesë muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës.

4. Shitësi i dërgon Blerësit kërkesat për sistemin e automatizuar.

823.750 USD (25% e vleftës Faza e parë)

Paraqet letrën e livrimit për konfirmim. Shtatë muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës.

5. Shitësi i dërgon Blerësit projekt idenë për ndërtesën.

329.500 USD (10% e vleftës Faza e parë)

Paraqet letrën e livrimit për konfirmim. Nëntë muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës.

GRAFIKU I PAGESAVE PËR FAZËN DYTË TË PROJEKTIT PËR MENAXHIMIN E HAPËSIRËS AJRORE KOMBËTARE (NAMP) NË SHQIPËRI

Faza e dytë – Përshkrimi i etapave
Vlefta totale e Fazës së dytë
Grafiku i pagesave për Fazën 2 do të vendoset nga të dyja Palët në Fazën e parë.
Kushtet dhe Afatet e Kontratës e Projektit për Menaxhimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (NAMP)

ANEKSI 4

Grafiku i implementimit të detyrës

Grafiku i përmbushjes së detyrës që është bashkëlidhur do të ripunohet për t'u përputhur me datën e hyrjes në fuqi të Kontratës pas nënshkrimit të saj

Versioni V2.0

Numri i Referencës: ALBGEN-0025

22 nëntor 2002

(Tabelat)

ANEKSI 5

Garancia e Koorporatës Mëmë

Datë

Zotërinj,

Kjo Garanci është bërë nga Lockheed Martin Global Inc. ("Lockheed Martin") në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të Qeverisë së Shqipërisë, zyrat e së cilës janë në adresën Rruga e Kavajës, Përballë Xhamisë, Tiranë, Shqipëri (Blerësi).

Lockheed Martin Global Inc., më poshtë referuar si LMGI, është ndihmëse e Korporatës Lockheed Martin dhe Blerësi ka lidhur me atë Kontratën Nr. _____, datë _____ në lidhje me Projektin për Hapësirën Ajrore Kombëtare (Kontrata).

Me anën e kësaj Lockheed Martin i garanton Blerësit realizimin e plotë nga LMGI-ja të detyrimeve të tij materiale për Fazën e parë të Kontratës. Në qoftë se LMGI-ja nuk përmbush detyrimet në realizimin e një ose më shumë nga detyrimet e saj materiale sipas Fazës së parë të Kontratës, atëherë Lockheed Martin, sa më shpejt e praktikisht të jetë e mundur, do të marrë përsipër të realizojë këto detyrime në përputhje me Kontratën, në varësi me të gjitha kufizimet, faljet dhe mbrojtjet që mund të ketë LMGI-ja, si të dala gjatë ekzekutimit të Kontratës ose ndryshe.

Përpara se të procedohet kundër Lockheed Martin sipas kësaj Garancie, së pari Blerësi (a) duhet t'i ketë dërguar një kërkesë me shkrim LMGI-së në lidhje me realizimin e detyrimeve për mallra të caktuara, duke pretenduar se janë neglizhuar dhe praktikisht nuk janë realizuar në përputhje me kërkesat e Kontratës për Fazën e parë dhe afati i zgjidhjes që mund të zbatohet për mosrealizime të tilla, siç përcaktohen në Kontratë, do t'u kishte kaluar afati pa u zgjidhur nga LMGI-ja, dhe (b) Blerësi do t'i dërgojë njoftim me

shkrim Lockheed Martin, në adresën që është më poshtë për këto mosrealizime nga ana e LMGI-së, dhe kërkesat e kësaj letre mund të plotësoheshin duke i transmetuar Lockheed Martin një kopje të njoftimit me shkrim përmendur më sipër ose kërkesën e dërguar te LMGI-ja në formën që është dhënë në Kontratë.

Kjo Garanci nuk do të shfrytëzohet për t'i imponuar Lockheed Martin ndonjë detyrim më të madh ose detyrime të tjera nga ato që konkretisht ka marrë përsipër LMGI për Fazën 1 të Kontratës, dhe Lockheed Martin nuk do të jetë përgjegjës për dëmtimet, duke përfshirë dëmtimet e kushtëzuara, aksidentale, specifike, indirekte ose të qëllimshme ose t'i ngakohen shpenzimet e padisë (duke përfshirë tarifat e avokatit, shpenzimet e gjykatës) për të cilat LMGI-ja sipas Kontratës nuk përgjigjet. Në asnjë rast detyrimet në rritje të LMGI-së dhe Lockheed Martin nuk do t'i kalojnë detyrimet e përgjithshme për të cilat LMGI-ja është e detyruar sipas Kontratës.

Kjo garanci mund të mos atribuohet nga Blerësi, e gjitha ose pjesërisht, pa shprehur miratimin me shkrim Lockheed Martin (dhe ky miratim mund të jepet ose të mbahet me të drejtën për të vendosur vetë Lockheed Martin).

Ky dokument përbën marrëveshjen e përgjithshme ndërmjet Lockheed Martin dhe Blerësit në lidhje me këtë Garanci. Nuk ka asnjë premtim, afat, kusht ose detyrim tjetër se këto që janë shprehur këtu dhe kjo Marrëveshje Garancie i anulon të gjitha komunikimet e mëparshme, përfaqësimet ose marrëveshjet, me gojë ose me shkrim, në lidhje me çështjet që janë këtu. Asnjë dispozitë e kësaj Garancie nuk mund të ndryshohet ose të korrigjohet, përveç, se me një dokument me shkrim të nënshkruar nga Lockheed Martin dhe Blerësi që shprehimisht i referohet dispozitave të kësaj Garancie.

Kjo Garanci në të gjitha aspektet do të kontrollohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjet e shtetit të Nju Jorkut, SHBA, duke përfshirë të gjitha çështjet e përmbajtjes, të vlefshmërisë dhe të realizimit, pavarësisht nga zgjedhja e saj të dispozitave të ligjit.

Kjo Garanci hyn në fuqi më _____ dhe vazhdon më tej duke përfshirë plotësimin e të gjitha detyrimeve materiale të LMGI-së për Fazën e parë të Kontratës.

Korporata Lockheed Martin

Nga _____
Name
Titulli
Adresa:

Aneksi 6

Letërkredi Rezervë për Pagesë Avancë

Banka që çel kredinë: Emri i Bankës Amerikane që çel kredinë
Adresa e Bankës që çel kredinë

Banka informuese: Emri i Bankës shqiptare informuese

Përfituesi: Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil
e Republikës së Shqipërisë
Rruga e Kavajës, Përballë Xhamisë
Tiranë, Shqipëri

Aplikanti: Korporata Lockheed Martin
6801 Rockledge Drive
Bethesda, MD 20817

Data e skadencës:

Shuma: US\$ 329.500.00

Zotërinj,

Me urdhër të klientit tonë, Korporata Lockheed Martin, për llogari të Lockheed Martin Global Inc. (Shitësi) nëpërmjet kësaj çelimi letrën e kredisë rezervë e të pakthyeshme nr. _____ (Letër Kredie) në favorin tuaj në shumën 329.500 USD (treqind e njëzet e nëntë mijë e pesëqind dollarë të SHBA-së), e cila përbën 10% (dhjetë përqind) të vlefës totale të Fazës së parë të Kontratës nr. _____ që lidhet me Projektin për Modernizimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare (Kontrata).

Kjo Letërkredi do të hyjë në fuqi automatikisht me marrjen e korrespondencës telegrafike origjinale të bankës suaj, duke iu referuar numrit të kësaj Letërkredie dhe duke njoftuar se janë transferuar telegrafisht 329.500 USD në llogarinë e Shitësit, nr. 4070-3579 në Citibank-New York. Me marrjen e këtij telekomunikimi autentik ne do t'ju dërgojmë juve njoftimin tonë nëpërmjet bankës informuese, duke u vënë në dijeni se kjo Letërkredi tashmë është funksionale.

Fondet do të jenë në dispozicion për t'u paguar me paraqitjen e dokumenteve origjinale, duke u shoqëruar me sa më poshtë:

Vërtetimin tuaj me firmë origjinale nga një nëpunës i autorizuar i Qeverisë Shqiptare.

Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, duke deklaruar se Shitësi është në pamundësi të livrimit të një ose më shumë mallrave të livrueshme për Fazën e parë, sipas nenit nr. (cilësohet nr. Neni) i Kontratës nr. _____, se mosrealizimi po vazhdon për një periudhë të paktën 45 ditë në vazhdim të njoftimit me shkrim që ju i keni dorëzuar Shitësit dhe se ky mosplotësim nuk është shfajësuar në përputhje me ndonjë klauzolë të Kontratës nr. _____ dhe se nuk është rezultat i ndonjë ngjarjeje të Forcës Madhore (siç përcaktohet në Kontratë).

b) Kopja e letrës suaj dërguar Shitësit nëpërmjet shërbimit postar ndërkombëtar 24 orësh, të paktën 45 ditë para datës së kësaj kërkesë për pagesë, duke e njoftuar Shitësin se nuk ka mundësi të livrojë një ose më shumë mallra të livrueshme për Fazën e parë, sipas nenit nr. (cilësohet nr. neni) i Kontratës nr. _____ dhe se ky mosrealizim nuk është shfajësuar në përputhje me ndonjë klauzolë të Kontratës nr. _____ ose nuk është shkaktuar nga ndonjë veprimi juaj ose pamundësia juaj për të vepruar dhe nëse ky mosrealizim nuk rregullohet brenda 45 ditëve, duke filluar nga data e kësaj letrë, është detyra juaj të kërkonit pagesën në shumën USD (cilësohet shuma) sipas Letërkredisë rezervë nr. _____; dhe

c) Kopje e vërtetimit, se letra i është dërguar Shitësit nga shërbimi postar ndërkombëtar 24 orësh.

Tërheqjet pjesore lejohen me kusht që vlefë totale e tërheqjes ose tërheqjeve nuk e kalon shumën që disponohet më poshtë.

Është kusht i kësaj Letër Kredie që të ulet progresivisht me nga 11,1% të vlefës së secilës Faturë të etapës për Fazën e parë të Kontratës dhe kjo ulje hyn në fuqi automatikisht me paraqitjen nga Shitësi të kopjes së faturës së tij që mbulon etapën e caktuar.

Kjo Letërkredi do të skadojë më (data e përafërt 10 muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës) në sportelet e (vendi i Bankës) ("Data e Skadencës"). Me anën e kësaj ne deklarojmë se jemi dakord që urdhër pagesat në bazë dhe në përputhje me kushtet e shprehura këtu do të respektohen rregullisht nëse paraqiten në ose para Datës së Skadencës.

Kjo Letërkredi paraqet në formë të plotë kushtet e sipërmarrjes sonë dhe një sipërmarrje e tillë në asnjë mënyrë nuk do të modifikohet, korrigjohet ose plotësohet duke iu referuar ndonjë dokumenti, akti ose marrëveshjeje që përmendet këtu ose që kjo Letërkredi mund të ketë lidhje.

Kjo Letërkredi i nënshtrohet Rregullave dhe Praktikave Uniforme për Kreditë Dokumentare, e ripunuar në vitin 1993, Botim i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nr. 500.

ANEKSI 7 LETËRKREDI DOKUMENTARE

Banka që çel kredinë:

Emri i Bankës që çel kredinë

Banka ndërmjetëse:

Adresa në SHBA e Bankës ndërmjetëse
Përfituesi

Aplikanti:

Data e çeljes:
Data e skadimit:
Monedha dhe Shuma:
Aplikanti:

Data e skadencës:
Shuma: USD 329.500.00

Adresa e Bankës që çel kredinë
ëDëgë të Bankave Qendrore të Amerikës së Veriut dhe
Vendeve të Evropës Perëndimore në SHBA]

Lockheed Martin Global Inc.
[Adresa e Lockheed Martin]
Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil e Republikës së
Shqipërisë, Rruga e Kavajës,
Përballë Xhamisë
Tiranë, Shqipëri

12 muaj pas hyrjes në fuqi të Kontratës
USD 2.965.500.00
Korporata Lockheed Martin
6801 Rockledge Drive
Bethesda, MD 20817, SHBA

Zotërinj,

Me porosi të klientit tonë, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil e Republikës së Shqipërisë (Aplikanti), me anën e kësaj çelim në favorin tuaj Letërkreditë tonë Dokumentare, të pakthyeshme Nr. ënr. i Kredisë], (Letërkredia) në shumën USD 2.965.500.00 (dy milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind dollarë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës). Një shumë e tillë përbën 90% të vlefës të Fazës së parë të Projektit për Modernizimin e Hapësirës Ajrore Kombëtare sipas Kontratës Bazë nr. ë] (Kontrata).

E disponueshme me: Bankën Ndërmjetëse, me Negociata.

Dërgesat pjesore: Të lejueshme

Pagesat pjesore: Të lejueshme

Fondet sipas kësaj Letërkredie do të jenë të pagueshme për përfituesin me paraqitjen e këtyre dokumenteve:

- 1) Orgjinali i kësaj Letërkredie dhe çdo amendament që mund të ketë.
- 2) Një kopje origjinale e urdhër pagesave të tërhequra, në Bankën që çel kredinë.
- 3) Tri kopje të nënshkruara me dorë të Faturave tregtare të Shitësit, duke evidentuar kryerjen e pagesave të aplikuara sipas etapave dhe shumat e faturës, siç përcaktohet në Grafikun e Pagesave me Faza si më poshtë:

GRAFIKU I PAGESAVE ME FAZA

Nr. pagesës	Përshkrimi i etapave	Data e parashikuar për të përfunduar	% ndaj vlefës Fazës së parë të Kontratës	Shuma e faturës në USD
A	Livrimi i Ofertave Tregtare të Bankës	2 muaj pas hyrjes në fuqi	30%	\$988.500.00
B	Livrimi i pajisjeve për ndërtesat	5 muaj pas hyrjes në fuqi	20%	\$823.750.00
C	Livrimi i kërkesave për automatizimin e sistemit	7 muaj pas hyrjes në fuqi	20%	\$823.750.00
D	Livrimi i planit të ndërtimit	9 muaj pas hyrjes në fuqi	10%	329.500.00

Afatet e realizimit janë thjesht për qëllim reference. Tërheqjet mund të paraqiten pa renditje, sepse çdo tërheqje e veçantë kërkohet jo më shpejt se data e realizimit e parashikuar për etapën që do aplikohen dhe para skadencës së kësaj Letërkredie.

Për njoftimin tuaj vlefë totale e Kontratës është USD 3.295.000.00 nga e cila USD 329.500.00

janë paguar në avancë nga Përfituesi jashtë kësaj Letërkredie.

Të gjitha urdhër pagesat dhe fatuarat e paraqitura për këtë Letërkredi do të shënohen me numrin e kësaj Letërkredie Dokumentare.

Nëse nuk zgjatet nga ne, kjo Letërkredi do të skadojë në sportelet e bankës ndërmjetëse në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 12 ditë pas hyrjes në fuqi të Kontratës (data e skadimit). Njëpërmjet e kësaj jemi dakord se urdhërpagesat e tërhequra sipas kushteve të shprehura këtu, do të respektohen rregullisht nëse paraqiten në ose para datës së skadimit.

Të gjitha shpenzimet e bëra në lidhje me lëshimin dhe ekzekutimin e kësaj Letërkredie në Shqipëri, si edhe shpenzimet për konfirmimin janë në llogari të Aplikantit. Të gjitha shpenzimet e bëra në SHBA, duke përfshirë shpenzimet e konfirmimit, janë për llogari të Përfituesit.

Kjo Letërkredi i nënshtrohet Rregullave dhe Praktikave Uniforme për Kreditë Dokumentare, e ripunuar në vitin 1993, Botim i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, nr. 500 (UCP500) dhe na angazhon ne sipas kushteve të saj. Nëse Letërkredia skadon gjatë ndërprerjes së punës nga Banka livruese ose nga Banka ndërmjetëse, siç përshkruhet në nenin 17 të UCP500, Përfituesi mund të paraqesë ankesë për këtë brenda 30 ditëve pas fillimit të punës nga Banka livruese dhe/ose Banka ndërmjetëse.

Instruksonet për Bankën negociuese: Me marrjen e dokumenteve në përputhje me afatet dhe kushtet e kësaj Letërkredie ëAlternativa 1: jeni e autorizuar të debitonit në llogarinë tonë nr. _____] ose ëAlternativa 2: lutemi paraqisni ankesën tuaj për ribursimin të (emri i bankës ribursimit në USA].

Bankës negociuese i kërkohet të dërgojë të gjitha dokumentet me një dërgesë postare te:

_____.